



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR

Nr. Prot.

Vlorë, më 31.05.2017

**STRATEGJIA PESE VJECARE 2017-2022
E KERKIMIT SHKENCOR**

Kjo strategji u hartua në përputhje me Ligjin Nr 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Startegjinë Kombëtare për Zhvillimin dhe Integrim 2015-2020, Strategjinë e Ndërkombëtarizimit të Universitetit "Ismail Qemali".

FILOZOFIA E KERKIMIT SHKENCOR

Kërkimi shkencor është shtylla kryesore ku mbështetet arsimi i lartë dhe është bazë për balancimin e dijeve teorike me ato praktike. Zhvillimi i Kërkimit shkencor parallisht me mësimdhënien është një nga kërkesat kryesore për implementimin e sistemit të Bolonjës në universitetet të cilat synojnë të jenë pjesë e Zonës Europiane të Arsimit të Lartë.

Kërkimi shkencor është nxitës rritjes ekonomike dhe progresive. Ai përcakton rrijen ekonomike, krijimin e vendeve të reja të punës dhe progresin një vendi.

Verprimtaria kërkimore shkencore shtrihet në këto drejtime: Revistat shkencore, Konferencat shkencore Simpoziume, Workshop, Botimet shkencore dhe Grupet e kërkimit.

MISIONI DHE VIZIONI I UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" VLORE

Universiteti ka si qëllim identitetin dhe profilin e tij. Edhe pse një Universitet reativisht i ri vetem 23 vjet, universiteti bazohet në një traditë të konsoliduar duke u zhvilluar në shumë drejtime; si në shkencat ekonomike (tradihtë që buron prej shkollës Tregtare në Vlorë), shkencat detare (tradihtë që buron prej Shkollës së Marinës), shëndeti publik (tradihtë që buron prej Shkollës Mjeksore), pedagogjisë së specializuar (tradihtë që buron prej Shkollës Pedagogjike). Synimi i Universitetit është jo vetëm të ruaj traditën e tij, por njëkohësisht të zgjerojë dhe të zhvillojë degë të tjera të kërkua nga tregu si;



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR

Drejtësia, Shkencat Kompjuterike, si dhe programe studimi profesionale një dhe dy vjeçare dhe teknik-profesionale.

Qëllimi kryesor është dhe ndërkombëtarizimi, hapja e Universitetit në bashkëpunime me institucionet europiane të arsimit të lartë dhe pjesëmarrja në kërkime shkencore dhe projekte Europiane. Me qëllim përmbushjen e këtij misioni UV ka ndërmarrë disa hapa: struktura dhe zyra e re e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Projekteve, është krijuar Bordi Këshillues i Jashtëm, zhvillimi i rrjetit të diasporës Zv. Rektorit për Zhvillimin Institucional. Deri më tani, në kuadër të ndërkombëtarizimit janë implementuar disa projekte si: INTERREG, Erasmus dhe përpjekja për HORIZON 2020, e cila është në zhvillim, si dhe pjesëmarrja në projektin EPACTT-2 e Fakultetit të Shëndetit Publik.

Rritja dhe përmirësimi i cilësisë është qëllim në vetvete i UV-së. Është ndërmarrë rikonstruksioni i Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Me qëllim, rritjen e cilësisë, janë miratuar kriteret për matjen e performancës së stafit akademik dhe ndihmës akademik. Qëllimi ynë është të rrisim cilësinë e UV duke synuar që, deri në 2025 UV të jetë ndër Universitetet më të mira të rajonit por edhe më të mira në Shqipëri.

Krijimi i "Smart University" për qëllim uljen e burokracisë dhe rritjen e aksesit në shërbimet on-line. Përmes tij synojmë të lehtësojmë procedurat, shmangim burokracitë, kursejmë kohë dhe rrisim kënaqësinë e studentëve duke rritur cilësinë.

Programet e përbashkëta të studimit me Universitetet jashtë Shqipërisë (joint master and joint PhD) është synim mbi të cilin ka filluar tashmë të punohet dhe të lidhen kontaktet e para.

Hapja e programeve të studimit në anglisht. Ky synim do t'i shërbejë Universitetit edhe për rritjen e mobiliteteve, si për studentët e huaj, po ashtu edhe për pedagogët. Çdo departament do të ketë mundësinë të sjellë pedagog nga Universitete të huaja.

Universiteti i Vlorës synon të jetë leader në rajon. Ky synim do të realizohet duke lidhur universitetin me tregun duke shtuar bashkëpunimin e tij me aktorët e ndryshëm në rajon si publik ashtu edhe privat.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR

SYNIME

- Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë synon të bëhet një qendër e rëndësishme dhe pikë referimi kombëtare e rajonale në kooperimin akademik universitar, kërkimin shkencor, aktivitetin botues dhe promovimin e vlerave zhvilluese të arsimit të lartë.
- Universiteti synon të jetë pjesë integrale e rrjeteve dhe strukturave të organizuara institucionale universitare në kuadrin e rajonit të Europës jug-lindore, vendeve të BE-së.
- Synon përfshirjen në sa më shumë projekte zhvilluese akademike shkencore në kuadrin e projekteve të arsimit të lartë.
- Synon evidentimin e anëve të saj të forta dhe dobësive në fushën e kërkimit shkencor.
- Synon ndërkombëtarizimin e aktiviteteve kërkimore të saj.

- Synon inkurajimin, zhvillimin dhe dinamizmin e aktiviteteve kërkimore shkencore, vazhdimësi duke bashkëpunuar me struktura të tjera të kërkimit shkencor brenda vendit.
- Realizimin e kërkimit shkencor dhe shpërhapjen e rezultateve të kërkimit të stafit të saj akademik me qëllim rritjen e impaktit të kërkimit në publik.
- Integrimin e kërkimit shkencor në procesin e mësimdhënies.
- Bashkëpunimin e sektorin publik dhe privat në realizimin e projekteve kërkimore.
- Përfshirja e studentëve në aktivitete kërkimore.

- **Veprimtaria kërkimore-shkencore**

1. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, kryen veprimtari kërkimore-shkencore bazë ose të zbatuara, studime, projekte për zhvillim dhe veprimtari të tjera krijuese, të përcaktuara në statutin e UV, sipas natyrës dhe objektivave specifike të UV. Ato garantojnë integrimin e veprimtarisë kërkimore në atë të mësimdhënies.
2. Veprimtaria kërkimore-shkencore synon të mbështetë zhvillimin në nivel lokal, rajonal dhe më gjerë si dhe rritjen e cilësisë së arsimit.
3. Nëpërmjet veprimtarisë kërkimore-shkencore personeli akademik dhe studentët fitojnë aftësi për kërkime të pavarura, në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm profesional dhe të karrierës akademike.

- **Kërkimi Shkencor në Universitetin e Vlorës**

1. Veprimtaritë e kërkimit shkencor në Universitetin e Vlorës realizohen mbi bazën e programeve dhe projekteve në përputhje me statutin dhe rregulloret e universitetit, fakulteteve, departamenteve dhe qendrave të kërkimit shkencor.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR

2. Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ka të drejtë të hartojë programe dhe projekte kërkimore në bashkëpunim me institucione të tjera publike ose private, brenda dhe jashtë vendit.
3. Universiteti ofron, nëpërmjet veprimtarive kërkimore-shkencore shërbime për të tretë. Të ardhurat nga këto veprimtari administrohen nga njësi bazë ose ajo kryesore, që realizon veprimtarinë, sipas përcaktimeve ligjore.

Kërkimi Shkencor sipas Ligjit për Arsimin e Lartë:

Ministria e Arsimit dhe Sportit ka ndërmarrë hapa për asocimin e Shqipërisë në Programin e BE-së për kërkimin shkencor Horizon 2020. Ky program ofron mundësi shumë të mira për të zhvilluar projekte të kërkimit shkencor në nivel rajonal por edhe global. MAS mbështet me financim strukturor dhe programator projekte cilësore dhe novatore të kërkimit shkencor. Kërkimi shkencor është një nga shtyllat e rëndësishme të Ligjit për Arsimin e Lartë por dhe një ndër pikat ku Shqipëria do të vlerësohet si vend kandidat për BE. Në buxhetin e këtij viti kërkimi shkencor zë vetëm 0.4% të GDP nga 1-2% që është rekomandimi i BE.

Veprimtaria e Kërkimit Shkencor sipas ligjit zhvillohet nga :

- a) Institucionet e arsimit të lartë
- b) Institutet dhe qendrat ndërinstytucionale të kërkim zhvillimit
- c) Institutet e kërkim- zhvillimit pranë ministrive.

Ligji përcakton Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit si institucionin publik përgjegjës në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve e cila ka për detyrë kryesore shpërndarjen e fondeve për programet e kërkimit shkencor, mbi bazën e projekteve të paraqitura prej institucioneve të arsimit të lartë dhe institucioneve të kërkimit shkencor në fushat e shkencave natyrore, inxhinierike dhe teknologjike, mjekësore, buqësore, sociale dhe humane.

- ❖ AKKSHI-ja identifikon fushat prioritare të kërkimit shkencor, teknologjisë dhe inovacionit, si dhe vlerëson në nivel kombëtar programet e projektet në fushat e sipërpërmendura.
- ❖ AKKSHI-ja është përgjegjëse për përhapjen e informacionit dhe koordinimin e proceseve të aplikimit në projekte ndërkombëtare të kërkimit shkencor në arsimin e lartë.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR

- ❖ AKKSHI-ja miraton mbi bazën e konkurrencës së lirë midis aplikantëve, fonde për projektet e studimeve të doktoraturës.
- ❖ Agjensia administron edhe fonde të tjera të kërkimit shkencor dhe inovacionit në kuadrin e programeve kombëtare, ndërkombëtare dhe dypalëshe të kërkimit shkencor, të cilat i shpërndan bazuar në aplikimet e institucioneve.

Agjensia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit ka për detyrë kryesore sipas Ligjit për Arsimin e Lartë shpërndajen e fondeve publike për:

- Mbështetjen e veprimtarisë së institucioneve publike të arsimit të lartë ku përfshihet mësimdhënia, kërkimi shkencor dhe pjesëmarrja në çështje të menaxhimit akademik
- Mbështetjen në bursa studimi
- Garantimi i skemës së kredive studentore

Veprimtaria e Kërkimit shkencor realizohet mbi bazën e programeve dhe projekteve të miratuara nga vetë Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë në bazë të Statutit dhe Rregullores. Është detyrë e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe e gjithë administratës të universitetit të nxisë kërkimin-shkencor.

Misioni i punës kërkimore shkencore dhe akademike të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë gjen shprehje në një shumëllojshmëri formash duke variuar që nga studimet bazë tek hulumtimet e aplikuara dhe të drejtuara ndaj problemeve të veçanta. Universiteti siguron mbështetje financiare për punë kërkimore shkencore dhe akademike dhe njëkohësisht është në kërkim të burimeve të jashtme të mbështetjes.

Granti i punës kërkimore-shkencore:

- Granti i punës kërkimore-shkencore përfshin fondet për kërkimin shkencor.
- Pjesë e këtij granti janë edhe fondet për studimet e doktoratës, të cilat u jepen institucioneve të arsimit të lartë mbi bazën e aplikimit. Nga ky fond përjashtohet financimi i ngarkesës së pedagogëve për udhëheqjen e doktoratës.

Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor

- Këshilli i Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor (KALKSH) është organ këshillimor për politikat e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, pranë ministrit përgjegjës për arsimin.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR

Struktura e fakulteteve dhe departamenteve të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë

- Fakultetet si njësi kryesore bashkërendojnë mësimdhënien dhe kërkimin shkencor në fusha të përafërta ose të ndërthurura.
- Departamentet nxisin, programojnë, bashkërendojnë, zhvillojnë, organizojnë dhe administrojnë veprimtarinë e mësimdhënies dhe atë kërkimore-shkencore. Çdo departament duhet të ketë databaset e tij për aktivitetin shkencor: Konferenca, Sinpoziume të organizuara nga vetë departamenti, Botime shkencore të pedagogëve, aktivitetet dhe përfshirje në botime shkencore të studentëve.
- Studimet e doktoraturës :
Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë ofron studime të doktoratës në Matematikë dhe të hartojë projekte kërkimore-shkencore dhe zhvillimi për këto studime. Numri i studentëve doktorantë përcaktohet nga njësia bazë dhe projekti kërkimor i çdo doktoranti përcaktohet në varësi të projekteve kërkimore të kësaj të fundit.
- Qendra kërkimore-shkencore e fakultetit është njësi bazë që kryen veprimtari kërkimore-shkencore dhe zhvillimi.
Qendra mund të mbështetë realizimin e programeve të studimeve "Master i shkencave" dhe "Dokoratë", të ofruara nga departamentet e fakultetit përkatës ose departamente të fakulteteve të tjera.

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë përbëhet nga katër fakultete, departamentet përkatëse si dhe qendrat kërkimore-shkencore.

Fakulteti i Shkencave Teknike :

- Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare
- Departamenti i Shkencave Detare
- Departamenti i Shkencave Kompjuterike
- Departamenti i Matematikës
- Departamenti i Biologjisë
- Departamenti i Kimisë
- Departamenti i Fizikës

Fakulteti i Shkencave Humane :

- Departamenti i Drejtësisë
- Departamenti i Edukimit



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR

- Departamenti i Gjuhëve të Huaja
- Departamenti i Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë

- **Fakulteti i Shëndetit Publik:**
- Departamenti i Infermierisë
- Departamenti i Kujdesit Shëndetësor

Qendra kërkimore-shkencore:

- Qendra Kërkimore-Shkencore e Fakultetit të Shkencave Teknike
- Qendra Kërkimore-Shkencore e Fakultetit të Ekonomisë
- Qendra Kërkimore-Shkencore e Shëndetit Publik
- Qendra Kërkimore-Shkencore e Albanologjisë dhe Ballkanistikës
- Qendra e Formimit Profesional e Fakultetit të Shkencave Teknike

**FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANE STRATEGJIA PESË VJEÇARE
(2017 – 2022) E KËRKIMIT SHKENCOR**

Fakulteti i Shkencave Humane është një prej katër njësive kryesore të Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë. Misioni dhe vizioni i këtij fakulteti janë pasqyrim i misionit dhe vizionit që Universiteti i Vlorës ka dhe që synon të arrijë në këtë periudhë pesë vjeçare. Fakulteti i Shkencave Humane, për vetë natyrën e degëve që ofron, është ngushtësisht i lidhur me aktivitetin njerëzor. Fakulteti i Shkencave Humane mbështet zhvillimin e mëtejshëm të aktivitetit njerëzor në disa fusha si atë të pedagogjisë, drejtësisë, gjuhëve të huaja dhe gjuhë letërsisë, duke i parë këto aktivitete si të ndërlydhura dhe në bashkëveprim të vazhdueshëm njëra me tjetrën. Qëllimi i këtij fakulteti në pesë vitet e ardhshme është ai i fokusimit në mënyrën se si aktiviteti i ushtruar në këtë fakultet mund të shtrihet dhe të ndikojë përmes përfshirjes edhe shoqërinë. Larmishmëria e degëve të ofruara paracakton në të njëjtën kohë edhe larmishmëri në fushën e kërkimit shkencor. Fakulteti ynë ofron programe të ciklit të parë të studimit në një varietet degësh, përmes të cilave synohet ofrimi i njohurive bazë në këto fusha. Secila prej njësive bazë të këtij fakulteti ofron programe të ciklit të dytë të studimeve, duke kontribuar në mundësinë e krijimit të profesionalistëve. Krijimi i qendrës kërkimore shkencore është një hap më tepër drejt realizimit të kërkimit



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR

shkencor në mënyrë më konkrete dhe në të njëjtën kohë edhe me të ndjeshme. Së fundmi ndryshimi i strukturës së njësive bazë të fakultetit përmes krijimit të grupeve mësimore kërkimore – shkencore, përbën daljen nga tradita e vjetër e konceptimit të mësimdhënies në një filozofi të re, në të cilën mësimdhënia del nga auditori dhe realizohet edhe përmes përfshirjes në aktivitetin kërkimor shkencor.

Fakulteti i Shkencave Humane, e mbështet strategjinë kërkimore – shkencore në shtyllat e mëposhtme:

- **Programe studimi bashkëkohore.** Modernizimi i programeve dhe kurrikulave të ofruara. Fakulteti i Shkencave Humane bazohet në traditën e disa degëve dhe në të njëjtën kohë ofron edhe degë të reja të kërkuara në treg. Programet e ofruara prej tyre ndiejnë nevojën që përgjatë kësaj periudhe të modernizohen duke marrë në konsideratë edhe nevojat e tregut dhe sygjerimet e studentëve.
- **Objektivi janë studentët.** Strategjia e kërkimit shkencor ka në rradhë të parë si objektivi të saj studentët. Inkurajimi dhe përfshirja e studentëve në aktivitetin kërkimor – shkencor është një ndër qëllimet kryesore të çdo njësie bazë në përbërje të këtij fakulteti. Studenti është implementuesi i produktit që ne ofrojmë, si i tillë ai përbën subjektin kryesor ku duhet investuar me profesionalizëm të plotë si në aspektin mësimdhënës dhe në atë kërkimor. Qëllimi është t'a lidhim studentin me tregun sa pa dalë ende në të.
- **Partneritet.** Bashkëpunimi me aktor rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar është një shtyllë e fortë mbi të cilën janë ndërtuar politikat e Fakultetit të Shkencave Humane dhe që ndihmojnë në arritjen e objektivave të këtij fakulteti. Bashkëpunimi i mëtejshëm me partnerët do të sjell rritjen e efektivitetit të punës së stafit akademik por në të njëjtën kohë do të ndihmojë në krijimin e mëtejshëm të faciliteteve edhe për studentët.
- **Ndërkombëtarizim** në mësimdhënie dhe në kërkim shkencor. Mobiliteti i pedagogëve dhe i studentëve është një ndër qëllimet kryesore të kësaj strategjie.
- **Ngritja dhe fuqizimi i qendrave kërkimore shkencore.** Njësitë bazë të fakultetit kanë rritur aktivitetin e tyre shkencor, gjë e cila kulminon me krijimin e qendrave kërkimore shkencore.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR

Fakulteti i Shkencave Humane është i organizuar në katër(4) departamente:

- Strategjia e Kërkimit Shkencor (2017-2022) i Departamenti të Drejtësisë

Strategjia e Kërkimit Shkencor e Departamentit të Drejtësisë është një dokument që pasqyron planifikimin 5- vjeçar të punës dhe të zhvillimit të departamentit. Kjo strategji përcakton objektivat kryesore dhe sfidat në vitet në vazhdim, si dhe mënyrat, mjetet dhe masat konkrete për realizimin e tyre.

Hartimi i strategjisë ka kaluar në disa faza: (a) të propozimeve, (b) të diskutimeve, (c) të hartimit dhe (d) të miratimit të saj nga asambleja e njësisë bazë.

Kjo strategji na ngarkon me përgjegjësinë, që puna jonë duhet të ketë në fokus kërkimin shkencor cilësor, na përball me sfidat për t'u identifikuar si një pjesë përbërëse e rëndësishme e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, si një vlerë e shtuar e tij, që konkurren dhe spikat në mjedisin e arsimit të lartë në Shqipëri.

Në pesë vitet e ardhshme (2017-2022) synohet:

- forcimi i kërkimit shkencor, duke e përqendruar vëmendjen në grupet mësimore-shkencore, që aktualisht funksionojnë në përbërje të departamentit **Penal, Civil dhe Publik**.
- Të rritet niveli i kerkimit cilësor ,individual ose jo nga stafi akademik i Departamentit. Realizimi i këtij objektivi do të realizohet nëpërmjet motivimit dhe mbështetjes financiare për botime në revista shkencore prestigjioze dhe pjesëmarrje në konferenca të organizuar jashtë vendit.
- Programi pesë-vjeçar i studimeve të integruara është një risi dhe një sfidë për departamentin, për të garantuar formimin e plotë dhe cilësor të studentëve. Në vitet në vazhdim një nga objektivat do të jetë edhe hartimi i programeve të reja Master ekzekutiv, profili i të cilëve do të përcaktohet nga kërkesat e studentëve në p nevojat e tregut.
- Departamenti i Drejtësisë synon të realizojë programe studimi të përbashkëta "jointprograms" në nivelin Master, duke mundësuar përfitimin e një diplome të dyfishtë, nëpërmjet bashkëpunimit me universitete të huaja partnerë.
- Studentët duhet të motivohen për të marrë pjesë në trajnime, takime shkencore dhe shkolla verore.
- Departamenti i Drejtësisë ka një rol të rëndësishëm në rajon, stafi akademik kanë qenë shpesh pjesë në projekte si konsulentë apo ekspertë për çështje të ndryshme ligjore, bashkëpunimi i tyre i vazhdueshëm me organizata jofitimprurëse ka treguar nevojën për eksperiencën e stafit të departamentit.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR

- Me krijimin e "Klinikës së Ligjit", që do të shërbejë si një ndihmë reale për shtresat në nevojë, por gjithashtu edhe si një mundësi e shkëlqyer për studentët për të zbatuar në praktikë, gjithçka të fituar nëpërmjet mësimdhënies.

Strategjia e kërkimit shkencor e Departamentit të Drejtësisë, në mënyrë që të realizohet në përputhje të plotë me objektivat e vet, kërkon angazhimin e konkret dhe të vazhduar të anëtarëve të stafit akademik dhe, padyshim, mbështetjen institucionale dhe financiare të autoriteteve dhe organeve kompetente të Universitetit.

- **Strategjia e Kërkimit Shkencor(2017-2022) i Departamenti të Edukimit**

Plani strategjik i DGJH-së për 2017-2020 është konceptuar duke u nisur nga veçantitë, përvojat e mira dhe sukseset e deritanishme të departamentit, duke u frymëzuar nga përvojat e mira botërore në kërkim, si dhe duke marrë parasysh sfidat e reja në kërkim në planin kombëtar dhe ndërkombëtar për t'iu përgjigjur në mënyrë sa më koherente dhe efikase vizionit dhe misionit të UV-së të orientuar drejt ndërkombëtarizimit. Vizioni i DGJH-se për kërkimin shkencor për 2017-2020 është krijimi i një mjedisi nxitës për ekselencë në kërkim, mbështetje për kërkuesit dhe studiuesit, sidomos kërkuesit e rinj, përmes përmirësimit të kushteve dhe faciliteteve kërkimore me synimin e çuarjes përpara dhe zbatimin e njohurive të reja.

- **Synimet**

- Orientimin e programeve të studimit drejt komponentit të kërkimit shkencor.
- Forcimit dhe rritjes të kapaciteteve njerëzore në kërkim.
- Thellimin e bashkëpunimeve ekzistuese me institucione partnere në kërkim si dhe krijimin e lidhjeve, bashkëpunimeve dhe partneriteteve të reja me aktorë të ndryshëm vendas dhe rajonalë.
- Krijimin e një mjedisi nxitës për ekselencë në kërkim duke inkurajuar dhe mbështetur kërkimin në të gjitha nivelet, që nga studentët deri tek kërkuesit.
- Nxitja e lëvizjes së kërkuesve për shkëmbim përvoja
- Mbështetjen dhe nxitjen e kërkimit (bazë dhe të zbatuar) përmes formave të ndryshme të shpërndarjes së informacionit.
- Afrimin e kërkimit me shoqërinë dhe komunitetin përmes qasjes RRI (Responsible Research and Innovation – Kërkim dhe Inovacion i Përgjegjshëm)



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR

- **Realizimi i prioriteteve strategjike**
 - Ndërthurja e kërkimit me arsimimin
 - Zgjerimi i partneritetit dhe bashkëpunimit
 - Përmirësimi dhe krijimi i kushteve për kërkim
- **Veprimtaria kërkimore-shkencore e DGJH-së ngërthen katër fusha kryesore, secila prej të cilave përfshin tematika bashkëkohore si vijon:**
 - Studime/shkenca gjuhësore
 - Studime letrare
 - Studime kulturore
 - Edukim dhe mësimdhënie e gjuhës së huaj
- **Matja e arritjeve do të kryhet përmes:**
 - identifikimit të treguesve kryesore të performancës dhe një sërë mjeteve të tjera matëse për të parashtruar nevojat tek drejtuesit e UV-së, si dhe për të orientuar buxhetin për kërkimin. Për këtë do të bazohemi kryesisht tek praktika të mira botërore.
 - Identifikimit të dobësive, mundësive dhe pikave të forta për të planifikuar fushat dhe prioritetet në kërkim me vijimësi. Mjetet e përdorura do të jenë vëzhgimet, pyetësorët, intervistat me stafin dhe studentet.
 - Vendosja e një sistemi menaxhimi të performancës në kërkim, e cila do të synojë matjen e arritjeve. Kjo do të kryhet përmes një modeli të gatshëm, ku do të radhiten qëllimet/treguesit e performancës, të cilat më pas do të verifikohen dhe shënjohen.
- **Strategjia për Kërkimin Shkencor(2017-2022) të Departamentit të Gjuhës Shqipe dhe Letrësisë**

Ky plan strategjik i DGJSHL-së për kërkimin shkencor në periudhën 2017-2020 është konceptuar në kushtet e krijuara me ligjin e ri për arsimin e lartë. Në këtë dokument paraqitet vizioni dhe misioni i DGJSHL-së për kërkimin shkencor, identifikohen fushat kryesore të kërkimit në DGJSHL, arritjet e synuara në kërkim, planin e veprimit për zbatim për periudhën 2017-2020. Vizioni i DGJSHL-së për kërkimin shkencor për vitet 2017-2020 është krijimi i një ambienti motivues e mbështetës për kërkimin shkencor, krijimin e infrastrukturës së nevojshme në mbështetje të kërkuesve dhe studiuesve dhe krijimi i një produkti konkret e të suksesshëm



Veprimtaria e DGJSHL-së deri në momentin aktual është e përqendruar në katër shtylla:

1. Mësimdhënie: DGJSHL ofron dy programe studimi, (1) 'Bachelor në Gjuhë Shqipe dhe Letërsi' dhe (2) 'Master i Shkencave në Mësimdhënie e Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë' .
2. Mësimdhënie e gjuhës shqipe në programe të tjera, përkatësisht në programet Bachelor në Edukim (Mësimdhënie në Ciklin e Ulët), Bachelor në Edukim (Mësimdhënie në Ciklin Parashkollor), Bachelor në Gjuhën Angleze, Bachelor në Gjuhën Italiane.
3. Kërkim shkencor: Veprimtaria shkencore e DGJSHL-se është përqendruar kryesisht në organizimin e pjesëmarrjen në konferenca shkencore disiplinare e ndërdisiplinare, botimin e artikujve, përmbledhjeve dhe botime të tjera shkencore, organizimin e aktiviteteve të ndryshme shkencore kombëtare e ndërkombëtare.
4. Shërbime për të tretë (parashikuar në Ligjin për AL, nr. 80/2015, pika 9, neni 25)

Synimet:

- Nxitja e mbështetja e kërkimit përmes formave të ndryshme të shpërndarjes së informacionit, krijimit të mundësive financiare të mundshme.
- Krijimin e lidhjeve me nevojat e komunitetit
- Krijimin e infrastrukturës për të inkurajuar e mbështetur studentët e të gjitha cikleve në kërkim.
- Krijimin e platformave kërkimore ndërdisiplinare në kërkimin shkencor qoftë brenda strukturës ekzistuese të FSHH apo edhe jashtë tij.
- Vazhdimin e bashkëpunimeve ekzistuese me institucione partnere në kërkim.
- Krijimin e lidhjeve, bashkëpunimeve dhe partneriteteve të reja me aktorë të ndryshëm vendas, rajonalë dhe më gjerë në funksion të përfitimit të ndërsjelltë.
- Nxitja e lëvizjes së kërkuesve për shkëmbim përvojash.
- Orientimin e programeve të studimit drejt komponentit të kërkimit shkencor.
- Forcimit dhe rritjes të kapaciteteve njerëzore në kërkim.



Fusha e veprimtarisë kërkimore-shkencore (bazë dhe të zbatuar)

Veprimtaria kërkimore-shkencore e departamentit është e fokusuar në fushat:

1. Studime/shkenca gjuhësore
2. Studime letrare
3. Studime kulturore
4. Mësimdhënie e gjuhës dhe letërsisë

Prioritetet strategjike dhe realizimi i tyre:

1. Forcimi i rolit të departamentit në kërkim.
2. Rritja dhe forcimi i bashkëpunimit
3. Përmirësimi dhe
4. Cilësi dhe etikë në kërkim

Matja e arritjeve do të kryhet përmes

- identifikimit të dobësive, mundësive dhe pikave të forta për të planifikuar fushat dhe prioritet në kërkim me vijimësi. Mjetet e përdorura do të jenë vëzhgimet, pyetësorët, intervistat me stafin dhe studentet.
- identifikimit të treguesve kryesorë të performancës dhe një sërë mjetesh të tjera matëse për të parashtruar nevojat tek drejtuesit e UV-së, si dhe për të orientuar buxhetin për kërkimin. Për këtë do të bazohemi kryesisht tek praktika të mira botërore.
- Vendosja e një sistemi menaxhimi të performancës në kërkim, e cila do të synojë matjen e arritjeve të vendosura në fillim të vitit nga stafi dhe realizimin e tyre në fund të vitit. Kjo do të kryhet përmes një modeli të gatshëm, ku do të radhiten qëllimet/treguesit e performancës, të cilat më pas do të verifikohen dhe shënjohen.

- **Strategjia për Kërkimin Shkencor(2017-2022) të Departamentit të Edukimit**

Kërkim shkencor: Veprimtaria shkencore e DE-së është përqëndruar kryesisht në përcaktimin e profilit të ngushtë të kërkimit për çdo lektor, si përparësi e domosdoshme sot, në iniciimin e veprimtarive shkencore të nivele të ndryshme disiplinare e ndërdisiplinare, në rritjen e pranisë së departamentit përmes botimeve në opinionin e kualifikuar profesional, në maksimalizimin e përfitimeve të mundshme prej mundësive që ofrojnë burimet e Universitetit dhe të Rajonit e më gjerë.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR

Gjendja e sotme dhe caktimi i objektivave për periudhën 2017-2022 ne DE:

Përkufizojmë disa vërejtje që lidhen me të kuptuarin e procesit akademik e të përparësive që burojnë prej interpretimit të tij:

- Zbatimi i programve që ofron departamenti lidhet me një traditë të ngurtësuar të kategorive disiplinare e të metodave të mësimdhënies që duhet kapërcyer. Departamenti ka nevojë të forcojë profilin e vet të vecantë midis njësive akademike të llojit:
- Literatura e shfrytëzuar bazike vijon të mbetet konservatore, ka nevojë për të ngjashme një traditë pothuaj e provuar. Nevojitet shtimi i kontaktit të gjallë me informacionin e pasur, e sidomos aty ku tradicionalizmi është zotërues. Duhet theksuar se mangësitë janë pasoja të një kulture zotëruese akademike (p.sh., tekstet, literatura bibliografike, instrumentet interpretues) dhe se përpjekjet individuale përbëjnë aspektin pozitiv të procesit. Problematika përkatëse në mendojmë se lidhet më stadin e ende fëmijëror kulturor të marrëdhënies sonë me filologjinë moderne.
- Domosdoshmëri shfaqet rritja e peshës së kurseve të aftësisimit praktik në strukturën e programit. Praktika është nga kjo pikëpamje dëshmi e së vërtetës teorike, jo rast për të provuar teorinë në mësimdhënie.

Për periudhën 2017 – 2022 do të synohet:

- Në mësimdhënie:
 - Rishikimi strukturor i kurrikulës në përputhje me frymën e ndryshimeve ligjore (Ligjin për AL, nr. 80/2015), në shërbim të një programi më të përshtatshëm, më të përvetësueshëm e më në shërbim të studentëve.
 - Ndërtimi i një etikë të re bashkëveprimi mes lektorëve e studentëve në funksion të krijimit të një bashkësie ku ndërveprohet caktohen pikesynime dhe mberrihen rezultate.
 - Hapja e DNP Psikologji Shkollore.
 - Hapja e Masterit të Shkencave për degën Histori – Gjeografi (kërkese e bërë në MAS prej vitit 2014).
 - Forcimi dhe kthimi i programit të Pedagogjisë Forcimi dhe kthimi i programit të Pedagogjisë së specializuar në Qendër burimore kërkimore shkencore në zbatim të nenit nr 27 të ligjit 80/2015.
 - Hapja e qendrës së këshillimit dhe trainimit në Departament, në bashkëpunim edhe me kompani të licencuara për trainim këshillim nga MAS, në zbatim të nenit 95 të ligjit 80/2015.
 - Krijimi i një qendre Historiko-Gjeografike në ambientet e Departamentit, për Arkeologjinë, Historinë sipas etapave historike të studimit dhe për Gjeografinë sipas fushave të studimit me synimin e prodhimit të Guidave historike gjeografike turistike që do të mbulojë këto nevoja:
 - a. për studentët
 - b. për të tjerët



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR

- c. për departamentin
- d. projekte ndërfaqultetore
- e. pjesëmarrje në konferenca brënda dhe jashtë vendit

Marrëdhënia me problematikat

Departamenti i Edukimit ka krijuar në kohë profil të qartë akademik e kërkimor, madje ka synuar edhe standarde. Pengesë e dukshme për rritjen e qendrueshmërisë së profilit ka qenë, pa dyshim, mungesa e autonomisë, politika e centralizuar e financimit dhe e punësimit, mungesat infrastrukturore, të cilat nuk e kanë lejuar forcimin e identitetit akademik të departamentit.

- Infrastruktura është pika më dobët e sistemit
- Mobilimi është i papërshtatshëm e jo dinjitoz
- Biblioteka
- Shërbimet ndaj të tretëve

Objektivat e përcaktuar për periudhën 2017-2020

Afatshkurtër:

- Nxitja dhe promovimi i programeve Erasmus + për përfitimin e Bursave të Mobilitetit të Stafit akademik dhe Studentëve.
- Do të mësohet ruajtjes dhe vazhdimësisë së programeve akademike që kanë probleme mbylljeje, përmes riformimit të programeve dhe këshillimi sensibilizimit të nxënësve të shkollave të mesme dhe studentëve të programeve bachelor.
- Atashimi i përfaqësuesve të DE në komisionet e përhershme të UV-së si dhe në organet e emëruara nga Rektori dhe Dekani në mbrojtje dhe mbështetje të kërkesave dhe problematikave të pedagogeve të DE.
- Sigurimi i kushteve optimale infrastrukturore në sallat mësimore ,zyrat e pedagogëve dhe atyre personale (kompjuterat, lap-top, printer fotokopje ,projektorë etj) sipas grupseksionve mësimore kërkimore shkencore.

Afatgjatë:

- Të llobohet që të krijohen lidhje me pushtetin vendor, për të plotësuar nevojat e departamentit dhe universitetit, sidomos kur ato figurojnë të rëndësishme në planifikimin e komunitetit, apo ndihmojnë rehabilitimin e politikave rajonale arsimore në zhvillim, etj.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR

- Të krijohet mundësia e trajnimit të pedagogëve, në një nga universitetet që janë brenda rrjeteve tona të komunikimit shkencor brenda dhe jashtë vendit mbështetur në marrëveshjet ndëruniversitare.
- Të lidhen marrëveshje të përbashkëta me institucionet e pushtetit vendor, DAR/ZA QKK, Institucionet Arsimore Publike dhe Jopublike si dhe Institucionet e Aftësisë së Kufizuar OJQ-ve, OJF-ve për të mundësuar forma indirekte apo direkte shpërblimi moral e financiar për studentët më të mirë.
- Të bëhet planifikimi i numrit të studentëve që mendohet të pranohen në degët e Fakultetit të Shkencave Humane dhe kryesisht të Departamentit të Edukimit.
- Të punohet për të bërë ndërfaqultetore ,ndërdepartamentare, programe lëndore të domosdoshme për të gjitha degët dhe fakultetet si: komunikimi (Psikologji komunikimi), Psikologji e përgjithshme, Pedagogji, Metodologji Mësimdhënie (në programet master të degëve të mesuesisë)
- Të punohet për ndarjen e grupeve të pedagogëve në Departament me drejtim Mësimdhënie dhe personel kërkimor shkencor dhe reduktimin e ngarkesës 70% me 30%, 30% me 70% .

FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK STRATEGJIA E KËRKIMIT SHKENCOR 2017-2022

Strategjia e kërkimit shkencor 2017-2022 për Fakultetin e Shëndetit Publik do bazohet në Strategjinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit 2017-2022 si dhe në vizionin e universitetit "Ismail Qemali" Vlorë e cila synon të rrisë dhe zgjerojë kërkimin klinik dhe të siguroj evidencë për kujdes shëndetsor klinik efektiv dhe të sigurtë me fokus pacientin.

Qëllimi është që të bëhet një pikë referimi në fushën e kërkimit shkencor në nivel kombëtar dhe rajonal për profesionistët e shëndetit si dhe të njihet si lider në zhvillimin dhe mbështetjen e karrierës akademike klinike për infermierët e përgjithshëm, infermierët mami dhe profesionistët e tjerë të shëndetit duke i mëshuar traditës që buron nga ish shkolla Mjekësore, mbi bazat e të cilës është themeluar Fakulteti i Shëndetit Publik.

Ndërthurja e kërkimit shkencor me mësimdhënien synon që të diplomuarit në Fakultetin e Shëndetit Publik të integrohen me lehtësi dhe sukses në tregun global të punës.

Ky fakultet synon të identifikohet si "Qendër e Zhvillimit Rajonal", me lidhje të forta me komunitetin lokal dhe me vëmendje të veçantë ndaj nevojave të komunitetit.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR

Strategjia synon përmirësimin e rezultateve në shëndet për individët, familjen dhe komunitetin nëpërmjet rritjes së kompetencave dhe aftësive, zhvillimit të vetëdijes kërkimore, si dhe kujdesit shëndetsor të bazuar ë evidenc shkencore, duke e renditur kërkimin shkencor të kryer në fakultet në një linjë me pritshmërinë kombëtare dhe ndërkombëtare.

- **Politikat e kërkimit shkencor në FSHP**

- a. Përmirësimi i kuadrit institucional, kapaciteteve infrastrukturore dhe kërkimore në shërbim të shëndetit publik.
- b. Nxitja e bashkëpunimit të strukturave shëndetsore shtetërore dhe private në projekte të përbashkëta kërkimore.
- c. Orientimi i kërkimit shkencor në FSHP ndaj nevojave të identifikuara në shërbimin shëndetsor
- d. Rritja e ndërgjegjësimit të strukturave shëndetsore për praktikimin e shërbimit shëndetsorv të bazuar në evidence dhe implementimin e rekomandimeve të kërkimit shkencor të aplikuar.
- e. Fuqizimi i bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar. Integrim në rrjetet shëndetsore europiane dhe amerikane.

- **Qëllimet Strategjike**

- a. Qendra Studimore për Shëndetin Publik të jetë qendër rajonale e ngritjes së politikave shëndetsore, në bazë të studimit tërësor të situatës epidemiologjike të rajonit dhe sigurim të aksesit për marrjen e informacionit.
- b. Forcimi i bashkëpunimit në kërkim dhe edukim me universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit si dhe organizata të tjera profesionale. Rritja e mobilitetit të stafik akademik.
- c. Optimizimi i kapaciteteve infrastrukturore dhe njerëzore për kërkim.
- d. Kërkimi shkencor të jetë i ndërthurur dhe në funksion të përditësimit, rifreskimi e zgjerimit të bazës teorike dhe praktike të kurrikulës së studimeve.



• **Objektivat dhe plani i veprimit të QSSHP për periudhën 2017-2022:**

1. Krijimi i bazës formale dhe informale të të dhënave, që çdo ndryshim protokollit në menaxhimin e shërbimeve shëndetsore të argumentohet nëpërmjet studimeve të fizibilitetit apo eksperimentale nëpërmjet botimit të një raporti për të gjitha punimet e kryera në fushën e shëndetit nga stafi akademik i fakultetit, studentët dhe profesionistët shëndetsor. Fillimi i projektit nis në 2018. Synohet bashkëpunimi me partnerë lokal dhe kërkimi i financimit nga organizata fitim dhe jo fitimprurëse. Gjatë kësaj periudhe 5 vjeçare të strategjisë synohet krijimi i një baze të dhënash me mundësi diseminimin për të gjitha projektet e kryera nga FSHP.
2. Instalimi i bashkëpunimeve kyç për përfitim të ndërsjellë në iniciativa/projekte shëndetsore lokale, rajonale, globale përmes përfshijes së personelit shëndetsor operues në praktikën klinike në projektet kërkimore të FSHP. Brenda 2018 synohet ndërmarrja e një synimi për të identifikuar nevojat prioritare afatshkurtër, afatmesëm, afatgjatë në shkencat e shëndetit. Inkurajimin e projekteve individuale dhe pjesëmarrja në projekte ndërkombëtre Erasmus dhe projekte të tjera.
3. Forcimi i kontrollit të cilësisë së raportimeve kërkimore të publikuara përmes përdorimit të programit 'Safe Assignment' për kontrollin e plagjiaturës. Rekomandohet ngritja e një bordi këshillues për kërkimin shkencor me anëtarë të stafit akademik, hartimi i analizës vjetore të aktivitetit kërkimor të çdo anëtari të stafit, përshkrimi vjetor i veprimtarisë, a është në përputhje me planet strategjike të FSHP.
4. Arritje të standarteve kombëtare dhe ndërkombëtare për cilësinë, produktivitetin dhe fizibilitetin në programet kërkimore, vendosja e bashkëpunimeve në kërkim me partnerë lokale/rajonale dhe universitete, promovimi i krijimit të kërkimit të fakultetit.
5. Mbështetja e publikimit të rezultateve të rekomandimeve të studimeve shkencore përmes organizimit të një bienaleje periodike të FSHP në nivelin e konferencës shkencore ndërkombëtare, organizimi së paku 3 simpoziumeve/ seminareve/ work-shopeve vjetore nga departmentet dhe



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR

qendra kërkimore e FSHP për prezantimin e rezultateve të kërkimeve shkencore.

6. Identifikim I mundësive për kërkim të bazuar në praktikë në çështje dhe problematika të identifikuar nga profesionistët e shëndetit; organizimi i tryezave të rrumbullakta për evidentimin e nevojave të shëndetit komunitar dhe shërbimeve shëndetsore, pjesëmarrja e studentëve në identifikimin e problemeve të lidhura me praktikën profesionale.
7. Forcimi I rolit të FSHP në vendimarrjet e politikave shëndetsore: një anëtar I fakultetit çdo vit të jetë në pozicione drejtuese në shqata shëndetsore lokale ose kombëtare, përfshirja në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare qëkanë ndikim në ngrtje e politikave shëndetsore.
8. Profilizimi I kërkimit shkencor sipas fushës së studimeve tv departamenteve (grupet kërkimore shkencore brenda tyre), për të maksimalizuar impaktiin e tij.

- **Forcimi i bashkëpunimit në kërkim dhe edukim me universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit, si dhe me organizata të tjera profesionale.**

1. Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar me qendra të kërkimit shkencor: shkëmbimi I përvojës, instalimi i marrëdhënieve me të paktën 2 qendra kërkimore shkencore me fush të ngjashme studimi me FSHP një nga vendet e komunitetit europa dhe një nga SHBA.
2. Eksplorimi i oportuniteteve shtesë interdisiplinare me fakultete apo departamente te tjera te UV.
3. Rritja e mobilitetit të stafit akademik përmesmarrvveshjeve dypalëshe me Universitete të BE për aplikime në programet e mobilitetit të stafit dhe studentëve.

- **Optimizimi i kapaciteteve infrastrukturore dhe njerëzore për kërkim, në mbështetje të aktivitetit kërkimor-shkencor dhe çdo veprimtarie tjetër të FSHP.**

1. Forcimi I kapaciteteve kërkimore të stafit akademik ; trajnimi I stafit në fushën e kërkimit shkencor si dhe identifikimi e ftesa e ekspertëve nga fusha joakademike për të marrë pjesë në diskutime në tryeza të rrumbullakta.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR

2. Njohja dhe bërja publike e arritjeve në kërkim; publikimi çdo 6 muaj I newsletters online/njoftimeve në faqen e UV dhe dërgimi i tyre te alumni, fakultetet, studentët dhe partnerët lokal, dhe rritja financimit të UV për publikimin dhe prezantimin e rezultateve të studimeve
 3. Përmirësimi i infrastrukturës për kërkimit shkencor; akses në libraritë online, ngritja e laboratorit klinik-mikrobiologjik, ngritja e sallës audio-vizive për Qendrën e Trajnimeve të personelit shëndetsor, aplikimi për të qenë anëtarë në Cochrane Collaboratio.
 4. Sigurimi I financimit nga organizata fitim dhe jofitimpruese: kërkimi sistematik i fondacioneve private dhe krijimi i një database për aplikime për gjetje fondesh.
- **Kërkimi shkencor të jetë i ndërthurur dhe në funksion të përditësimit, rifreskimit e gjerimit të bazës teorike dhe praktike të kurrikulës së studimeve dhe ofrimit të shërbimeve komunitare(promocionit shëndetsor).**
1. Aplikimi i rekomandimeve dhe rezultateve të kërkimit shkencor në përmirësimin e edukimit akademik dhe në vazhdimësi: përditësimi i teksteve mësimore me të dhënat teorike dhe klinike, në përputhje me nevojat e profesionistëve për edukim në vazhdim për rajonin me përfshirjen e partnerëve klinik dhe organizatat lokale profesionale.
 2. Rritje e shërbimeve komunitare/ promovim i fakultetit: rritja e numrit të shërbimeve që FSHP ofron për komunitetin, hartim i udhëzuese parandalues për sëmundje komunitare, krijimi i një portali on-line për promocionin shëndetsor me informacione të përditësuara, zhvillimi I trajnimeve në komunitet, edukimii studentëve për një jetë qytetare aktive.
 3. Integrimi i studentëve në kërkim shkencor: inkurajimi i studentëve në kërkim I pjesë e dtyrave të kursit, projekteve, evidentimi I studentëve me prirje për kërkimin shkencor, botim i artikujve shkencor të studentvve nv bashkëpunim me stafin, iniciativa pvr mbledhje të fondeve për botim të punimeve shkencore të studentëve.

Fakulteti i shëndetit publik ka në strukturën e tij dy departamente; departamentin e Infermierisë dhe atë të Kujdesit Shëndetsor. Ky fakultet ka në përbërje dhe një qendër



kërkimore shkencore-Qendrën Studimore për Shëndetin Publik, e cila luan njëkohësisht dhe rolin e njësisë bazë.

- **Strategjia e kërkimit shkencor Departamenti i Infermierisë:**

Misioni i Departamentit të Infermierisë, si njësi bazë ë FSHP, bazuar dhe në statusin e UV, është të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve ndaj të tretëve.

Qëllimet e tij janë:

1. Të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anën mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve komunitare.
2. Të formojë specialistë të lartë në fushën e kujdesit shëndetësor, të kualifikuar dhe të përshtatshëm për tregun e punës në Shqipëri dhe në vende të tjera perëndimore.
3. Të ofrojë mundësi për të përfutuar nga arsimi gjatë të gjithë jetës (edukimi në vazhdimësi).
4. Të ndikojë në shëndetin komunitar nëpërmjet programeve dhe aktiviteteve të promovimit shëndetësor.
5. Të ndihmojë zhvillimin social në nivel rajonal dhe kombëtar.
6. Të integrojë mësimdhënien në Kërkim shkencor.

Problematika e këtij Departamenti të lidhura me burimet njerëzore janë:

- Mungesë e motivimit dhe stimulimit financiar për marrje me veprimtari kërkimore shkencore.
- Mungesë e përvojës për sigurimin e fondeve përmes projekteve kërkimore.

Bashkëpunimet ndërkombëtare

Anëtarët e DI ende nuk janë përfshirë në projekte ndërkombëtare individualisht.

Pjesëmarrja në partneritete ndërkombëtare mbetet objektiv strategjik i Departamentit të Infermierisë. Kjo do të realizohet nëpërmjet:



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR

- Rritjes së numrit të aplikimeve për projekte të përbashkëta kombëtare dhe ndërkombëtare.
- Krijimit të lidhjeve të qëndrueshme me partnerë ndërkombëtarë.

Për këtë arsye është e nevojshme trajnimi i stafit nga ana e zyrës së projekteve dhe zyrës së kërkimit shkencor për shkrim të projekteve dhe aplikim të projekteve.

Prioritetet e Strategjisë

- Implementimi i inovacionit në shkencë dhe praktikë
- Zhvillimi i brezit të ri të infermierëve shkencëtarë.
- Promovimi i 'Edukimit në Infermieri "të bazuar në evidence"' (evidence-based), nëpërmjet kërkimit shkencor, publikimeve, ekselencës pedagogjike dhe krijimin e partneriteteve të përbashkëta.

Objektivat e këtij departamenti

1. Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore për veprimtarinë kërkimore – shkencore kjo realizohet nëpërmjet: a) Vendosjen në funksion të plotë e grupit kërkimor-shkencor, b) Bashkëpunimit me zyrën e kërkimit shkencor dhe projekteve të UV – së për trajnime të stafit akademik, c) Kontakte të vazhdueshme me njësinë kryesore (FSHP) dhe UV për koordinimin e fondeve për mobilitet të stafit akademik në institucione kërkimore brenda dhe jashtë vendit, d) Bashkëpunimit me grupet kërkimore brenda FSHP
2. Integrimi i kërkimit shkencor me procesin e mësimdhënies. Kjo do të realizohet nëpërmjet: a) Grupi mësimor i departamentit do të funksionojë jo thjesht si grup mësimor, por do të integrohet dhe në kërkim shkencor, b) Kërkimi shkencor do të jetë në funksion të përditësimit, rifreskimit e zgjerimit të bazës teorike dhe praktike të kurrikulës së studimeve dhe ofrimit të shërbimeve komunitare (promocionit shëndetësor).
3. Ndërkombëtarizimi i veprimtarisë kërkimore – shkencore në DI kjo do të realizohet nëpërmjet: a) Rritjes së marrëveshjeve të partneriteteve strategjike me institucione të huaja të Arsimit të lartë me interes për DI, b) Rritjes së pjesëmarrjes së stafit akademik të DI në konferenca shkencore ndërkombëtare, c) Rritjes së numrit të publikimeve në revista shkencore ndërkombëtare, d)



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR

Organizimi i konferencave shkencore në bashkëpunim me njësitë e tjera bazë të FSHP, e) Promovimi i 'Edukimit në Infermieri "të bazuar në evidence" (evidence-based), nëpërmjet kërkimit shkencor, publikimeve, ekselencës pedagogjike dhe krijimin e partneriteteve të përbashkëta.

4. Bashkëpunimi me institucionet e shërbimeve shëndetësore për projekte kërkimore që janë në fushën e shërbimeve shëndetësore. Kjo do të realizohet nëpërmjet: Angazhimit të personelit shëndetësor dhe studentëve për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta.
5. Integrimi i studentëve cilësorë në punën kërkimore shkencore. Kjo do të realizohet nëpërmjet: a) Aftësisimit të studentëve për punë kërkimore shkencore, b) Integritit të studentëve me grupin kërkimor shkencor, c) Publikimit të artikujve të stafit akademik në bashkëpunim me studentët, e) Përfshirjen e studentëve në projekte ndërkombëtare.

- **Strategjia e kërkimit shkencor Departamenti i Kujdesit Shëndetsor**

Misioni i Departamentit të Kujdesit Shëndetësor është të krijojë, zhvillojë dhe mbrojë dijet me anën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve ndaj të tretëve.

Qëllimet e tij janë:

1. Të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anën e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve komunitare.
2. Të formojë specialistë të lartë në fushën e kujdesit shëndetësor
3. Të ofrojë mundësi për të përfituar nga arsimi gjatë të gjithë jetës (edukimi në vazhdimësi).
4. Të ndikojë në shëndetin komunitar nëpërmjet programeve dhe aktiviteteve të promovimit shëndetësor.
5. Të ndihmojë zhvillimin social në nivel rajonal dhe kombëtar.
6. Të integrojë mësimdhënien në Kërkim shkencor.

Fusha e interesit në kërkimin shkencor e Departamentit të Kujdesit Shëndetësor është përcaktimi i faktorëve determinant në shëndetin e komunitetit dhe ndikimi në politikat shëndetësore për përmirësimin e shërbimit shëndetësor parandalues dhe trajtues.

Bashkëpunimet ndërkombëtare



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR

Anëtarët e Departamentit të Kujdesit Shëndetsor kanë marrë pjesë në projekte ndërkombëtare individualisht:

1. Pjesë e grupit në një projekt të Departamentit të Inxhinierisë dhe Teknologjisë Detare (Modernizng and harmonizing maritime education in Montenegro and Albania – financim i programit Tempus,
2. EUR-HUMAN projekt,
3. Medical First Aid- IMO Model Course 1.14;
4. Projekti MAReD.

Objektivat e këtij departamenti:

Objektivi 1: Zhvillimi i kapaciteteve njerëzore për veprimtarinë kërkimore – shkencore në DKSH.

Kjo do të realizohet nëpërmjet: a) Bashkëpunimit me zyrën e kërkimit shkencor dhe projekteve të UV – së për trajnime të stafit akademik të DKSH lidhur me metodologjinë e punës kërkimore shkencore dhe përfshirjen në projekteve ndërkombëtare. b) Kontakte të vazhdueshme me njësinë kryesore (FSHP) dhe UV për koordinimin e fondeve. c) Bashkëpunimit me grupet e kërkimore brenda FSHP (grupin kërkimor shkencor pranë Departamentit të Infermierisë dhe Qendrës kërkimore të FSHP) dhe jashtë tij.

Objektivi 2: Integrimi i kërkimit shkencor me procesin e mësimdhënies. Kjo do të realizohet nëpërmjet grupit mësimor të departamentit dhe do të funksionojë jo thjesht si grup mësimor, por do të integrohet dhe në kërkim shkencor ku ndër prioritetet e tij duhet të jetë diskutimi në çdo vit akademik i syllabuseve lëndore dhe mënyrës së përfshirjes në syllabuse të arritjeve në fushat respektive.

Objektivi 3: Ndërkombëtarizimi i veprimtarisë kërkimore – shkencore në DKSH. Kjo do të realizohet nëpërmjet: a) Rritjes së marrëveshjeve të partneriteteve strategjike me institucione të huaja të Arsimit të Lartë me interes për DKSH. b) Rritjes së pjesëmarrjes së stafit akademik të DKSH në konferenca shkencore ndërkombëtare. c) Rritjes së numrit të publikimeve në revista shkencore ndërkombëtare. d) Organizimi i konferencave shkencore në bashkëpunim me njësitë e tjera bazë të FSHP.

Objektivi 4: Bashkëpunimi me institucionet e shërbimeve shëndetësore për projekte kërkimore që janë në fushën e shërbimeve shëndetësore. Kjo do të realizohet nëpërmjet:



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR

a) Angazhimit të personelit shëndetësor dhe studentëve për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta.

Objektivi 5: Integrimi i studentëve cilësorë në punën kërkimore shkencor. Kjo do të realizohet nëpërmjet: a) Aftësimit të studentëve për punë kërkimore shkencore, b) Integritit të studentëve me grupin kërkimor shkencor, c) Publikimit të artikujve të stafit akademik në bashkëpunim me studentët, d) Përfshirjen e studentëve në projekte ndërkombëtare.

FAKULTETI I SHKENCAVE TEKNIKE STRATEGJIA 2017-2022

Fakulteti i Shkencave Teknike zhvillon përherë politika të shëndetshme akademike, pasi mban përherë në konsideratë prioritetet strategjike kombëtare e rajonale, të cilat kanë qenë dhe mbeten "portantja" e konvergencës së filozofisë së adoptuar nga instancat drejtuese të Universitetit "Ismail Qemali" të Vlorës. Strategjia e kërkimit shkencor të Fakultetit të Shkencave Teknike për vitet 2017-2022, është hartuar si Dokument Strategjik që do të shërbejë si referencë zyrtare për zhvillimin e kërkimit shkencor të Fakultetit të Shkencave Teknike. Misioni i Fakultetit të Shkencave Teknike konvergjon në gjenerimin, zhvillimin, transmetimin dhe mbrojtjen e dijeve përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve. Ky fakultet ka në fokus formimin sa më cilësor dhe profesional të aseteve njerëzore, në mënyrë që çdokush të maksimalizojë pritshmëritë e perspektivën personale dhe njëkohësisht të jetë i aftë t'u përgjigjet sfidave të zhvillimit kombëtar shqiptar. Oferta e edukimit të Fakultetit të Shkencave Teknike përqëndrohet në përgatitjen e specialistëve, mësimdhënësve dhe teknikëve për fushat e: detarisë, inxhinierisë navale, mekanike dhe elektrike, teknologjisë së informacionit, informatikës, mjedisit, biologjisë, kimisë, matematikës dhe fizikës. Objektivi primar i këtij fakulteti është të vazhdojë të jetë një institucion edukimi i cili nxjerr në tregun e punës produkt dinjitoz, dinamik i cili përbën vlerë të shtuar për shoqërinë. Njëkohësisht, synon që diplomat që lëshohen të njihen dhe të kenë vlerë reale në tregun ndërkombëtar të punës.

- **Prioritetet strategjike:**

Me qëllim realizimin e synimeve, në terma arsimorë, kërkimore-shkencore dhe të kontributit ndaj shoqërisë, Fakulteti i Shkencave Teknike ka artikuluar një paketë Prioritetesh Strategjike,



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR

të cilat fokusohen në zgjerimin e gamës së kurrikulave akademike, orientuar nga nevojat dhe prioritetet e zhvillimit perspektiv të vendit. Prioritetet Strategjike të këtij fakulteti janë në harmoni me Strategjinë Kombëtare të Zhvillimit të Arsimit të Lartë, dhe vendosin theksin në:

- rritjen e cilësisë së mësimdhënies;
- zhvillimin e kërkimit shkencor;
- edukimin në vazhdimësi;
- ofrimin e shërbimeve komunitare.

Implementimi i tyre kalon përmes plan-veprimesh konkrete të cilat përfshijnë tërësinë e aktiviteteve akademike me shtrirje në çdo nivel të strukturës së fakultetit.

• **Objektivat për Kërkimin Shkencor 2017-2022**

1. Vendosja në efikasitet të plotë të Qendrës Kërkimore Shkencore të Fakultetit, duke e kthyer në një qendër në shërbim të stafit akademik dhe të studentëve të ciklit të dytë të studimeve, në kryerjen e shërbimeve për të tretët. Kalimin e saj drejt një njësie bazë, me disa fusha studimi dhe shërbimi si ato mjedisore, detare, kimike, fizike etj.
2. Konsolidimi i Qendrës së Trajnimit për Detarët dhe zgjerimin e paketës së Kurseve të Trajnimit.
3. Nxitja dhe mbështetja e kërkimit shkencor sipas fushës së studimeve të departamenteve (grupeve kërkimore-shkencore brenda tyre), për të maksimalizuar impaktin e tij.
4. Do të mbështeten dhe nxiten iniciativat për realizimin e projekteve kërkimore të përbashkëta me aktorë publikë e privatë rajonalë, kombëtarë e ndërkombëtarë.
5. Do të mbështetet dhe nxitet formalizimi dhe konsolidimi i lidhjes mes Fakultetit të Shkencave Teknike dhe Tregut të punës sipas sektorëve përkatës duke shfrytëzuar projektet kërkimore-shkencore.
6. Kërkimi shkencor do të jetë në funksion të përditësimit, rifreskimit e zgjerimit të bazës teorike dhe praktike të kurrikulës së studimeve, dhe ofrimin të shërbimeve komunitare.
7. Rritja e rendimentit të aplikimeve për projekte të përbashkëta kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe krijimin e lidhjeve të qëndrueshme me partnerë ndërkombëtarë për projekte të përbashkëta.
8. Do të mundësohet dhe do të nxitet, për çdo departament, komunikimi me AKKSHI mbi identifikimin e fushave prioritare të kërkimit shkencor, mbi projektet në nivel kombëtar, për informacion dhe koordinim të aplikimeve në projekte ndërkombëtare, për fonde për projektet e studimeve në doktoratë
9. Do të nxitet dhe do të mbështet stafi akademik për botime në periodikë shkencore universitare dhe proceedings si dhe për aplikime projektesh në nivel rajonal, kombëtar dhe më gjerë.
10. Në bashkëpunim me departamentet e FSHT do të punohet për organizimin në mënyrë periodike në çdo 2 ose 3 vjet, të një Konferencë Kombëtare/Ndërkombëtare dhe do të



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR

synohet përfshirja e studentëve cilësorë në aktivitetet/punë kërkimore shkencore, veçanërisht studentët e nivelit të dytë dhe të tretë të studimit.

11. Në bashkëpunim me departamentet dhe stafin akademik, Faqja WEB te FSHT do të përditësohet me informacione për aktivitetin shkencor të çdo njësie bazë (konferenca, sympoziume, workshope etj.)

- **Qendra Kërkimore Shkencore – FSHT**

Qendra Kërkimore Shkencore e FSHT nuk është krijuar rishtas por është vazhdimësi e Qendrës së Kërkimit Shkencor- Studime Mjedisore të Universitetit të Vlorës e cila është hapur për herë të parë në vitin 2009 në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Qendra Kërkimore Shkencore FSHT mendohet të riformatohet si në drejtim të infrastrukturës edhe në drejtim të fushave të studimit që do të ofrojë.

Misioni kryesor i Qendrës është krijimi i kushteve të përshtatshme dhe mundësimi i realizimit të kërkimit shkencor nga ana e stafit akademik të Fakultetit të Shkencave Teknike pranë ambienteve të saj. Bazuar edhe në vizionin e UV në lidhje me ndërkombëtarizimin, QKSH do të ketë si një ndër objektivat kryesorë, bashkëpunimin me institucionet evropiane të arsimit të lartë dhe pjesëmarrjen në kërkime shkencore dhe projekte Evropiane.

Krahas ndihmesës në kualifikimin e Stafit akademik në drejtim të kërkimit shkencor, QKSH do të jetë në funksion të përditësimit, rifreskimit e zgjerimit të bazës teorike dhe praktike të kurrikulës së studimeve, dhe do të mbështesë realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” dhe “Doktoratë”, të ofruara nga departamentet e fakultetit.

- **Politikat startegjike të QKSH**

Profilizimi i kërkimit shkencor sipas fushës së studimeve, për të maksimalizuar impaktin e tij. Është menduar që qendra të ofrojë disa fusha studimi:

1. Studimet Mjedisore
2. Metodatat Fizike dhe Instrumentale të Analizës
3. Materiale dhe metodatat Inxhinerike. Transporti dhe teknologjia detare
4. Zhvillim sistemesh në kohe reale, analizë statistikore të dhënash dhe modelim njohurish



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR

Ky organizim i fushave të studimit është menduar në mënyrë të tillë që secili prej anëtarëve të stafit akademik të FSHT të gjejë vetën për realizimin e kërkimit shkencor.

- ❖ Kërkimi shkencor do të jetë në funksion të përditësimit, rifreskimit e zgjerimit të bazës teorike dhe praktike të kurrikulës së studimeve, dhe do të mbështesë realizimin e programeve të studimeve "Master i shkencave" dhe "Doktoratë", të ofruara nga departamentet e fakultetit.
- ❖ Organizimi në mënyrë periodike (cdo dy-tre vjet) dhe pjesmarrja në Evente të ndryshme shkencore si: Konferenca Shkencore, WorkShop, Seminare në të cilat Qendra Kërkimore Shkencore do të bëjë publike rezultatet e kërkimit shkencor të realizuar nga stafi akademik apo edhe studentë.
- ❖ Botimi i një Buletini Shkencor nga ana e QKSH të FSHT një ose dy herë në vit ku do të mund të pasqyrohen arritjet e Kërkimit Shkencor të stafit akademik apo studentëve të FSHT por jo vetëm.
- ❖ Botimi i rezultateve të kërkimit shkencor të realizuar nga stafi akademik apo edhe studentë në Buletinin Shkencor të UV si dhe në revista Shkencore Kombëtare e Ndërkombëtare.

- **Bashkëpunimi institucional**

Në funksion të përmirësimit të cilësisë në lidhje me kërkimin, zhvillimin dhe inovacionin QKSH do të punojë për ndërveprim midis strukturave dhe institucioneve të ndryshme, private ose publike, brenda dhe jashtë vendit.

1. Kërkimi shkencor do të vihet në shërbim të rajonit dhe më gjerë duke realizuar projekte kërkimore të përbashkëta me njësitë vendore, universitete brenda dhe jashtë vendit. QKSH do të vazhdojë të konsolidojë marrëdhëniet e krijuara me partnerët e vet, si në planin kombëtar edhe atë ndërkombëtar, duke vijuar kontaktet në të gjitha drejtimet.
2. Duke qenë se një ndër qëllimet kryesore në vizionin e UV është ndërkombëtarizimi, hapja e Universitetit në bashkëpunime me institucionet evropiane të arsimit të lartë dhe pjesëmarrja në kërkime shkencore dhe projekte Evropiane është pjesë e strategjisë afatgjatë të QKSH është rritja e rendimentit të aplikimeve për projekte të përbashkëta kombëtare dhe ndërkombëtare. Edhe para riorganizimit qendra ka qene pjesmarrëse në projekte kombëtare e ndërkombëtare. Aktualisht, nën ndihmesën e Zyrës së Marrëdhënieve me Jashtë dhe Projekteve janë hartuar propozime për të qenë partner projekte në kuadër të INTERREG. Do të vazhdojnë përpjekjet edhe për të qenë pjesë e projekteve të tjera në bashkëpunim edhe me departamentet e FSHT.
3. Mundësimi për aplikim për marrje fondesh nga Agjensia Kombëtare për Kërkim Zhvillim e Inovacion në lidhje me ngritjen e metodikave analitike në QKSH, FSHT.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR

4. Krijimi i lidhjeve të qëndrueshme me partnerë ndërkombëtarë do të kërkohet mundësimi i bashkëpunimit (marje e përvojës) me universitete të shteteve fqinjë si Universiteti i Janinës, Barit, Leces e Tetovës.
5. Pjesë e strategjisë afatgjatë të QKSH është certifikimi dhe akreditimi i laboratoreve dhe paraqitja e metodikave të analizimit në përputhje me standartet e kërkuara për këtë qëllim. Kjo është shumë e rëndësishme për kryerjen e shërbimeve për të tretë.
6. Ofrimi i shërbimeve (kryerja e analizave) për palë të interesuara mënyrë kjo për të rritur të ardhurat e Qendrës dhe të UV dhe më tej fuqizimin e saj.

- **Strategjia e kërkimit shkencor Departamenti i Biologjisë**

Veprimtaria, ana pozitive dhe rezultatet e pritshme:

1. Ngritja e pasurimi i një database të përgjithshëm i të dhënave të florës e faunës (biodiversitetit). Realizimi i marrëveshjeve me Muzeun e Shkencave dhe Kopshtin Botanik në Tiranë dhe Agjensinë e Zonave të Mbrojtura Rajoni, Vlorë. Kërkime të vazhdueshme të stafit + Bch. e MSc.Larmia e habitateve të rajonit kjo realizohet përmes shkëmbim eksperiencash dhe realizim i praktikave në terren për zhvillimin e kërkimit shkencor të stafit dhe studentëve të Masterit shkencor kjo sjell vlerësimin sistematik të florës e faunës.
2. Kualifikimi i vazhdueshëm i stafit akademik për grada e tituj dhe realizimi i marrëveshjes me Fakultetin e Mjeksisë Veterinare, UBT, Tiranë. Premisa për ngritjen profesionale dhe kualifikimin kjo sjell shkëmbim eksperiencash dhe realizime të përbashkëta të punimeve shkencore si për stafin dhe studentët e Masterit Shkencor. Shtrirjen më tej te punës kërkimore shkencore .Përfshirjen e stafit të ri në kualifikim
3. Vlerësimi periodik mjedisor mbështetur dhe nga temat e diplomës së Bch e MSc. Përfshirja e Masterit Shkencor.
4. Botime e prezantime të punimeve shkencore të stafit në revista e konferenca shkencore kombëtare/ndërkombetare sipas standarteve të kërkuara. Prania e punimeve cilësore dhe arritje profesionale nëpërmjet punimeve dinjitoze
5. Publikim i punëve kualitative të studentëve të Master shkencor e Bachelor përmes krijimit të rrjeteve profesionale akademike të vazhdueshme. Mobiliteti i stafit. Ngritja e zbatimi i protokolleve vlerësues mjedisore.
6. Rritje e bashkëpunimit me homologët vendas e ndërkombëtar të fushës në kuadër të unifikimit të programeve. Mobiliteti i stafit . Organizime të përbashkëta kërkimore e shkencore dhe akademike
7. Aplikime të departamentit të Biologjisë në projekte të programeve kombëtare/ndërkombëtare. Sigurimi i projekteve me natyrë mjedisore/edukative



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR

8. Pasurimi i laboratoreve të Botanikës, Zoologjisë dhe Biologjisë molekulare. Prania e materialit të nevojshëm. Zhvillimi i të gjitha orëve të laboratorit me materialet e koleksionuara.
 9. Fillea për ngritjen e promovimin (turistik) e një muzeu të Biologjisë në ambientet e fakultetit. Përvoja e modeleve të ngjashëm me Universitete të tjera. Përvoja individuale e deritanishme e stafit. Sigurimi i ambientit e fillimi i punës për plotësimin e tij.
 10. Pasurimi i bibliotekës së departamentit të Biologjisë me tekste të disiplinës: hard copy + soft copy. Bashkëpunimi me revistat shkencore ku botohet ; ndihma nga politikat e UV. Sigurimi i një biblioteke me hard -copy e soft-copy (çelësa përcaktimi, materiale orientuese, etj).
 11. Krijimi i aksesit të punimeve të pedagogëve (+ studenteve) në faqen e departamentit të Biologjisë në faqen zyrtare të UV. Krijimi i disa kontakteve. Shtrirja e bashkëpunimit reciprok.
 12. Rritje e bashkëpunimit të stafit e studenteve me agjensi, organizata e qendra mjedisore vendase e të huaja. Prezantimi i punimeve.
- **Strategjia e kërkimit shkencor për Departamentin e Inxhinirive dhe Teknologjisë Detare 2017-2022**

Departamenti i Inxhinierive dhe Teknologjisë Detare, si njësi akademike brenda Universitetit "Ismail Qemali", synon që me veprimtarinë e tij mësimdhënëse dhe kërkimore shkencore të mbështesë vizionin e Universitetit "Ismaili Qemali" në të gjitha komponentët e tij. DITD synon që me zhvillimin e aktiviteteve mësimdhënë, kërkimore dhe zhvilluese të kontribuoj në përbushjen e politikave strategjike të zhvillimit të universitetit duke kontribuar në zhvillimet ekonomike në rajon. Departamenti synon të jetë Departament lider dhe promotor të zhvillimit të mendimit dhe kërkimit shkencor brenda FSHT/UV për ta kthyer atë në një qendër të ekselencës për kërkimet ndërdisiplinore në fushat që lidhen me inxhinierinë detare, mekanike, elektrike i hapur në bashkëpunime kërkimore me të gjithë aktorët brenda dhe jashtë UV.

Disa prej parimeve, standarteve dhe kritereve që shoqerojnë DITD^{ne} në përbushjen e rolit dhe misionit të DITD^{se} janë:

1. DITD ka si parim kryesor nxitjen, bashkërendimin dhe administrimin e veprimtarive kërkimore, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe të drejtën e tij për të shfrytëzuar burimet materiale dhe financiare në dispozicion dhe fushave të kërkimit të miratuara nga departamenti.
2. DITD si njësi bazë e FSHT/UV synon ndërkombëtarizimin e aktiviteteve kërkimore të saj. SI.3
3. DITD si njësi bazë e FSHT/UV synon inkurajimin, zhvillimin dhe dinamizmin e aktiviteteve kërkimore shkencore.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR

4. DITD si njësi bazë e FSHT/UV synon integrimin e arritjeve të kërkimit shkencor të personelit akademik të DITD^{sc} me ofertën e saj didaktike, në funksion të parimit të përmirësimit të vazhduar të programeve të studimit.
5. DITD si njësi bazë e FSHT/UV synon politikën e përfshirjes së studentëve cilësorë si pjesë e grupeve kërkimore brenda DITD^{sc}.
6. DITD si njësi bazë e FSHT/UV synon një bashkëpunim më të ngushtë me sektorin publik dhe privat në realizimin e projekteve kërkimore që janë në funksion të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror.
7. DITD si njësi bazë e FSHT/UV synon realizimin e kërkimit shkencor jo vetëm mbi baza individuale por edhe të grupeve kërkimore-shkencore sipas fushave të interesit të miratuara nga departamenti. (SI.4)
8. DITD si njësi bazë e FSHT/UV synon realizimin e kërkimit shkencor dhe shpërhapjen e rezultateve të kërkimit të stafit të saj akademik me qëllim rritjen e impaktit të kërkimit në publik dhe shkalljes së njohjes së DITD^{sc} si aktor i besueshëm në kërkim.
9. DITD si njësi bazë e FSHT/UV synon realizimin e kërkimit shkencor duke synuar integrimin me grupe të tjera kërkuese brenda FSHT/UV.

Gjendja dhe probleatika aktuale të DITD-së referuar kërkimit shkencor:

Disa prej problematikave të kërkimit shkencor në DITD të lidhura me burimet njerëzore janë:

1. Mungesë e motivimit dhe stimulimit për marrje me veprimtari kërkimore-shkencore;
2. Mungesë e përvojës dhe kapaciteteve të njësisë për sigurimin e fondeve përmes projekteve kërkimore (Horizon 2020,etj);
3. Aktivitete kërkimore sporadike, bazuar kryesisht në nisma individuale. Mungon fryma e bashkëpunimit në grup të stafit akademik të DITD.
4. Interesa në kërkim në fusha të ndryshme dhe ndonjëherë jashtë interesit të disiplinave të mësimdhënies të stafit të DITD^{sc}, kjo e vështirëson akoma më shumë frymën e punës në grup mes stafit akademik të DITD^{sc}.

Lidhja me botën e biznesit dhe shoqën e biznesit dhe shoqërinë:

Vendosja e lidhjeve midis botës së biznesit dhe grupeve kërkimore brenda DITD^{sc} në funksion të bashkëpunimit në fushën kërkimore-shkencore me qëllim final ndikimin dhe zhvillimin ekonomik dhe sipërmarrjes në rajon është një sfidë kryesore për DITD^{sc}. Kjo gjë do të ndikonte në masë domethënëse që dija që ofrohet në studime të jetë në përputhshmëri me kërkesat dhe nevojat e ekonomisë dhe shoqërisë. Aktualisht në DITD nuk ekziston bashkëpunim me botën e biznesit dhe me industrinë, sidomos përmes



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR

partneritetit publiko-privat, për gjenerimin e fondeve për kërkim dhe zhvillim. Konkretisht, DITD nuk ka lidhur marrëveshje që do të mundësonin bashkëpunimin dhe aplikimin e përbashkët me sektorin industrial dhe biznesin në fonde kërkimore-shkencore dhe zhvillimore. Edhe pse ka përpjekje sporadike të stafit të DITD^{SE} për bashkëpunime me botën e biznesit ka një tendencë të përgjithshme për të qëndruar larg aktorëve të biznesit. Edhe bota e biznesit nga ana tjetër nuk është shumë aktive për ti mundësuar stafit të DITD^{SE} mundësi për realizimin e projekteve të mirëfillta kërkimore shkencore. Vitalizimi i marrëdhënieve të bashkëpunimit midis DITD^{SE} do të ndihmonte në zhvillimin e një kërkimi shkencor aplikativ kualitativ, cka do të ishte në interes të të dy palëve.

Bashkëpunimet ndërkombëtare:

DITD është një Departament aktiv dhe i spikatur brenda FSHT në bashkëpunimet ndërkombëtare. Krahas bashkëpunimeve më të hershme të DITD^{SE} me Departamente homologe të Universiteteve të Triestes, Napolit, Genovës, aktualisht DITD është aktiv në bashkëpunime në kuadër të projekteve ndërkombëtare me Univesitetin Norvegjez të Shkencës dhe Teknologjisë, Fakultetin e Detarisë (Split, Kroaci), Fakultetin e Detarisë (Kotor Mal i Zi), Universiteti i Barcelonës (Spanjë), Universiteti Detar i Kostancës (Rumani), Fakultetin e Detarisë (Portorose, Slloveni), etj. Universiteti i Liezhit (Belgjikë) është universiteti më i fundit me të cilin DITD është në partneritet. Synimi është rritja e numrit të marrëveshjeve ndërkombtare me institucionet e huaja homologe të arsimit të lartë. DITD ka patur zbatime të projekteve ndërkombtare në nivel departamenti si;

- Albanian Maritime Interatinal Competitiveness Initiative- Financim i Qeverisë Norvegjeze.
- Modernizing and harmonizing maritime education in montenegro and Albania – Financim i program Tempus.
- Projekti shkencor ndërkombtar me titull “Realizimi i një laboratorit për testimin e materialeve të traditës dhe të së ardhmes” – Financim i qeverisë Italiane

Pjesëmarrja në partneritet në këto programe mbetet objektiv strategjik i DITD^{SE}.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR

Ojektivat, masat dhe rezultatet e pritshme:

- 1. DITD, si njësi bazë eUV/FSHT, në mënyrë periodike do të synoj evidentimin e anëve të saj të forta dhe të dobësive në fushën e kërkimit shkencor.**
 - Kërkimi shkencor ne DITD realizohet mbi baza individuale dhe grupesh kërkimore. Në fillim të çdo viti akademik përditësohet fusha e kërkimit mbi baza individuale ose në bazë grupi kërkimor
 - Në fund të çdo viti akademik grupet e kërkit raportojnë lidhur me ecurinë e aktivitetit kërkimor duke evidentuar arritjet dhe problematikat si dhe shpenzimet financiare për çdo grant të dhënë nga UV.
 - Mbi bazën e analizave të punës kërkimore shkencore sugjeron vazhdimësinë ose ndërprerjen e financimit për këto grupe kërkimore.
- 2. DITD si njësi bazë e FSHT?UV syno ndërkombëtarizimin e aktiviteteve kërkimore të saj.**
 - DITD angazhohet për të patur një komunikim në kohë reale me zyrën e projekteve për t'iu përgjigjur në kohë kërkesave për partneritet në projekte kërkimore ndërkombëtare, në përputhje me fushat e ekspertizës të stafëve kërkimore të DITD^{-së}.
 - Angazhohet të organizoj në mënyrë periodike konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushat përkatëse që mbulon.
 - Synon ndërkombëtarizimin nëpërmjet pjesëmarrjes së personelit akademik në konferenca ose aktivitete ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.
 - Në bashkëpunim me zyrën e projekteve UV do të synoj rritjen e marrëveshjeve të partneritetit me institucionet e huaja të arsimit të lartë.
 - Synon ndërkombëtarizimin nëpërmjet publikimeve të punës kërkimore të personelit akademik të DITD^{-së} në revista shkencore ndërkombëtare.
- 3. Synon inkurajimin, zhvillimin dhe dinamizimin e aktiviteteve kërkimore shkencore.**
 - DITD angazhohet të krijoj bazën e të dhënave të kërkimit shkencor të stafit akademik të DITD^{-së} për ta përcjellë më pas sipas afateve përkatëse pranë Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit AKKSHI.
 - DITD angazhohet për mbajtjen e kontakteve të vazhdueshme me AKKSHI, Zyrën e Projekteve dhe të Kërkimit Shkencor të UV^{-së} dhe të informojë në vazhdimësi stafin e saj akademik për mundësitë e financimeve të projekteve të reja, me synim mbështetjen financiare të grupeve kërkimore shkencore të DITD^{-së}
 - DITD angazhohet të ketë një frymë bashkëpunuese dhe mirëkuptimi reciprok me struktura të tjera kërkimore (qendrat e kërkimit shkencor apo grupet e kërkimit) të UV^{-së}.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR

4. DIT siguron vazhdimësi në fushën e kërkimit shkencor.

- Prioritetet e kërkimit shkencor do të jenë në fokus të veprimtarisë së përditëshme akademike të DITD^{-së}. Prej vitit të ardhshëm akademik anëtarët e grupeve kërkimore do të referojnë tema kërkimore në Departament në përputhje me planin e punës kërkimore të tyre.
- DITD angazhohet për të patur një frymë bashkëpunimi me struktura të tjera kërkimore shkencore brenda vendit, duke ofruar ekspertizën dhe asetet e saj në cdo rast të ftesave për bashkëpunime në kuadër të projekteve kërkimore.
- DITD angazhohet për të siguruar një politikë integruese në kërkimin shkencor të stafit të ri akademik dhe stafit aktual pa tituj dhe grada me stafin aktual me përvojë në fushën e kërkimit.
- DITD angazhohet për të ndjekur një politikë favorizuese për mobilitetin e personelit akademik që angazhohet në veprimtari kërkimore shkencore, duke synuar një integrim të kërkuesve të saj me kërkues të tjerë jashtë vendit
- DITD angazhohet për të qenë në krah të zbatimit të politikave shkencore rajonale dhe kombëtare, duke ndërmarrë nisma kërkimore në funksion të prioriteve kombëtare dhe rajonale.
- Për të nxitur rritjen e cilësisë, ndërkombëtarizimin dhe vazhdueshmërinë e kërkimit DITD angazhohet për të ftuar, sipas mundësive të saj dhe fondeve në dispozicion kërkues të huaj për mbajtjen e referateve shkencore në auditoret e DITD^{-së}. Kjo gjë do të realizohet përmes projekteve ndërkombëtare dhe mundësive të UV^{-së} për financimin e aktiviteteve të tilla.

5. DITD bën të njohura rezultatet në fushën e kërkimit shkencor.

- DITD si njësi bazë e FSHT/UV synon realizimin e kërkimit shkencor dhe shpërhapjen e rezultateve të kërkimit të stafit të saj akademik me qëllim rritjen e impaktit të kërkimit në publik dhe shkalljes së njohjes së DITD^{-së} si aktor i besueshëm në kërkim. Për të këtë të paktën 1 herë në dy vite DITD me propozim të grupeve kërkimore-mësimore duhet të organizoj një konferencë apo simpozium, që mund të jetë multidisiplinar ose brenda një disipline.
- DITD angazhohet për të ndjekur një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor të stafit akademik të DITD^{-së}.

6. DITD synon integrimin e kërkimit me procesin mësimdhënës.

- Kërkimi shkencor bazë dhe i aplikuar në DITD bëhet në funksion të integritimit të këtij kërkimi me procesin e mësimdhënies. Në funksion të këtij qëllimi grupet aktuale mësimore në DITD do të funksionojnë jo thjesht si grupe.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR

- synon integrimin e arritjeve të kërkimit shkencor të personelit akademik të DITD^{sc} me ofertën e saj didaktike, në funksion të parimit të përmirësimit të vazhduar të programeve të studimit.
- 7. DITD synon bashkëpunimi me sektorin publik dhe privat në realizimin e projekteve kërkimore.**
- Synon realizimin e kërkimit shkencor dhe shpërhapjen e rezultateve të kërkimit të stafit të saj akademik me qëllim rritjen e impaktit të kërkimit në publik dhe shkalljes së njohjes së DITD^{sc} si aktor i besueshëm në kërkim. DITD angazhohet për të ndjekur një politikë mbështetëse për organizimin e seminareve ndërkombëtare dhe simpoziumeve shkencore, duke shfrytëzuar edhe praktikën e konsoliduar tashmë me simpoziumin ndërkombëtar në fushën e Detarisë.
 - DITD angazhohet për të ndjekur një politikë mbështetëse për publikimet e rezultateve në fushën e kërkimit shkencor të stafit akademik të DITD^{sc}. Për këtë në bashkëpunim me zyrën e IT^{sc} të UV^{sc} planifikohet që cdo pedagog të ketë faqen e tij brenda Web^{it} të UV^{sc}, ku të jetë i pasqyruar i gjithë aktiviteti kërkimor.
- 8. DITD synon integrimin e kërkimit me procesin mësimdhënës.**
- DITD si njësi bazë e FSHT/UV synon integrimin e arritjeve të kërkimit shkencor të personelit akademik të DITD^{sc} me ofertën e saj didaktike, në funksion të parimit të përmirësimit të vazhduar të programeve të studimit.
 - Kërkimi shkencor bazë dhe i aplikuar në DITD bëhet në funksion të integritetit të këtij kërkimi me procesin e mësimdhënies. Në funksion të këtij qëllimi grupet aktuale mësimore në DITD do të funksionojnë jo thjesht si grupe mësimore, por si grupe mësimore-kërkimore.
- 9. DITD synon bashkëpunimi me sektorin publik dhe privat në realizimin e projekteve kërkimore.**
- Kërkimi shkencor i aplikuar është në fokus të politikës dhe strategjisë së kërkimit të DITD^{sc} dhe do të ketë për qëllim gjetjen e zgjidhjeve praktike dhe specifike me objektiv kryesor shfrytëzimin e njohurive teorike, me qëllim zbatimin e tyre në praktikë, për të kontribuar në zhvillimet ekonomike, sociale dhe kulturor në nivel kombëtar dhe rajonal. Ky objektiv strategjik do të arrihet nëpërmjet një bashkëpunimi më të ngushtë me sektorin publik dhe privat në realizimin e projekteve kërkimore.



10. Përfshirja e studentëve në aktivitetet kërkimore në DITD.

- Përfshirja e studentëve në aktivitetet kërkimore do të realizohet edhe në kuadrin e bashkëpunimeve të DITD^{ssë} me sektorin publik-privat, ku në këtë kuadër studentët do të angazhohen së bashku me personelin akademik për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta kërkimore-shkencore me sektorin publik dhe privat.
- DITD si njësi bazë e FSHT/UV synon politikën e përfshirjes së studentëve cilësorë si pjesë e grupeve kërkimore brenda DITD^{ssë}. Për këtë stafet akademike të DITD^{ssë} sipas grupeve mësimore-kërkimore do të identifikojnë ata studentë që kanë potenciale kërkimore, do ti aftësojnë ata për kërkim, do ti vendosin në provë nëpërmjet detyra të thjeshta.

- **Strategjia e kërkimit shkencor për Departamentin e Shkencave Kompiuterike 2017-2022.**

Departamenti i Shkencave Kompjuterike do të fokusohet në fushat e veprimtarisë kërkimore shkencore si më poshtë:

- Aplikim i teknologjive smart në funksion të "Smart University".
- Aplikim i teknologjive Data mining dhe machine learning në analizimin e të dhënave dhe nxjerrjen e njohurive.
- Zhvillim shërbimesh online në funksion të të tretëve.

Plani strategjik për periudhën 2017-2022:

1. Nxitje dhe mbështetje të punës kërkimore individuale të stafit në funksion të kualifikimit dhe të promovimit për marrjen e titujve akademik.
 - Gjithëpërfshirjen e stafit në punën kërkimore.
 - Mbështetje financiare për aktivitetin shkencor.
 - Nxitje e sfidave individuale dhe e punës në grup në kërkimin shkencor.
2. Zhvillimi i një kërkimi shkencor me rezultate të njohura kombëtarisht dhe ndërkombëtarisht.
 - Npërmjet botimeve të rezultateve të kërkimit në buletine shkencore universitare dhe revista kombëtare dhe ndërkombëtare me faktor impakti.
 - Pjesëmarrje në konferenca, simpoziume, workshop-e dhe seminare kombëtare dhe ndërkombëtare.
3. Pjesëmarrje në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare të lidhura me fushat e interesit të departamentit.
 - Aplikim projektesh në nivel ndërkombëtar pranë Erasmus+, Horizon 2020
 - Zhvillim i projekteve konkurruese për të përfituar nga fondet e UV për kërkimin shkencor.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR

4. Organizimi në mënyrë periodike çdo 2 vjet i Konferencës Ndërkombëtare NRA-CSIT.
5. Përfshirja e studentëve cilësorë në aktivitete dhe punë kërkimore shkencore.

- **Strategjia e kërkimit shkencor për Departamentin e Fizikës 2017-2022.**

Plani strategjik është përpunuar që të përcaktojë dhe formulojë qëllimet afatmesme e afatgjata të DF dhe të cilësojë mënyrat dhe mjetet për realizimin e tyre në kushtet e një mjedisi rrethues dinamik dhe konkurent. Ai është përgatitur pas një studimi të dokumentave vendore e europiane për zhvillimin e arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor. Kryesore mes tyre janë:

- Strategjia për rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse "Europa 2020";
- Strategjia kombëtare për zhvillimin e arsimit dhe kërkimit shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë.

Departamenti i Fizikës synon të shndërrohet në një qendër kryesore e cila do të japë ndihmesën e vet në zhvillimin e Universitetit dhe në zhvillimin rajonal. Ky departament ka këto objektiva:

- ❖ Krijimi i një grupi akademik (në nivel departamenti), bazuar në parimet e barazisë në të drejta, detyrime e përgjegjësi, ku çdonjeri është në qendër dhe të gjithë janë bashkëpunues me të gjithë. Ky grup ka për mision nxitjen e projekteve kërkimore dhe botuese (individuale e në grupe, bashkë-autorësi), si dhe organizimi i planifikuar i veprimtarive shkencore duke nisur me ato për njohjen dhe promovimin e krijimtarisë shkencore të njëri-tjetrit.

Kjo do të realizohet me anë të organizimit të seminareve shkencore brenda departamentit si dhe në konferenca të organizuara nga Fakulteti.

- ❖ Vendosija e veprimtarisë kërkimore-shkencore në qendër të aktivitetit të njësisë bazë si dhe renditja e Departamentit – mbi bazën e vlerësimit të jashtëm periodik të veprimtarisë kërkimore-shkencore – ndër departamentet më të mira me të ngjashmit e vet në rajon e më gjerë.
- ❖ Departamenti i Fizikës synon ta zhvillojë kërkimin shkencor në këto drejtime:
 1. Monitorimi i ekosistemeve ujorë në Qarkun e Vlorës në lidhje me shkallën e ndotjes
 2. Monitorimi ndotjeve akustike dhe elektromagnetike
 3. Monitorimi i ndotjeve të ajrit
 4. Studimi i materialeve me anë të metodave fizike



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR

5. Monitorimi I mërkurit në zonën e Ish PVC (2017-2018)
 6. Monitorimi I mërkurit në dhera, si pasojë e prurjeve të lumit Vjosë, përreth zonave të banuara. (2018-2020).
 7. Analiza e sedimenteve në ujra nëpërmjet metodave mikroskopike. (2017-2018). Analiza e sedimenteve në ujra (zona e Orikum-Pashaliman) nëpërmjet metodave mikroskopike. (2018-2020).
 8. Përmirësimi i kurrikulave të programeve të studimit në lidhje me integrimin e kërkimit shkencor në mësimdhënie.
- ❖ Integrimi real i mësimdhënies me kërkimin shkencor. Sfida e sotme nuk lidhet me informimin e studentit të painformuar, por me formimin e studentit të informuar. Kjo kushtëzon: (a) leksione që dalin edhe nga kërkimi i drejtpërdrejtë; (b) përfshirjen e studentit në projekte kërkimore të përbashkëta me pedagogun e të drejtuara prej tij; (c) shndërrimin shkallë-shkallë të raportit “pedagog-student” në “udhëheqës-kërkues”, sidomos në nivelin master; (d) rivlerësim të lëndëve që lidhen drejtpërdrejt me kërkimin.
 - ❖ Përfshirja e studentëve në kërkimin shkencor.
 - ❖ Rritja e vëmendjes mbi metodologjinë
 - Departamenti I Fizikës synon zgjerimin e partneritetit me çdo institucion që mund të ndihmojë në përmbushjen e misionit të tij, që nga organizatat lokale e më gjerë, duke përfshirë partnerë strategjikë (1), partnerë institucionalë (2), partnerë sipërmarrës (3) etj. Vendosija e marrëdhënieve të partneritetit të qëndrueshëm me institucionet vendore të juridiksionit të Bashkisë së Vlorës, sipas fushave të kërkimit shkencor të departamentit dhe prioriteteve të zhvillimit të rajonit.
 - Vazhdimi i partneritetit (të bazuar në marrëveshje) sidomos me institucionet arsimore; Drejtorinë Arsimore Rajonale (DAR) të Vlorës, me shkollat e niveleve të ndryshme, sidomos me shkollat e mesme – ku formohen studentët potencialë të Departamentit të Fizikës.
- **Strategjia e kërkimit shkencor për Departamentin e Matematikës 2017-2022.**

Departamenti i Matematikës ka përcaktuar si objektiva:

- përgatitjen e specialistëve në fushën e matematikës që të jenë të aftë për veprimtari kërkimore-shkencore dhe për aplikime të matematikës në fusha të ndryshme të ekonomisë dhe shoqërisë duke ju përgjigjur me kompetencë ndryshimeve të shpejta dhe zhvillimeve të teknologjisë.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR

- përgatitjen e lartë të mësuesve të matematikës për shkollat e mesme si nga ana shkencore ashtu dhe nga ana profesionale e mësimdhënies, të aftë për t'ju përgjigjur sfidave të arsimit dhe shoqërisë.
- rritjen e nivelit të cilësisë së mësimdhënies nga ana e stafit pedagogjik për të mbështetur të mësuarit aktiv dhe logjik dhe të menduarin kritik tek studentët për të rritur cilësinë dhe jetëgjatësinë e përvetësimit të njohurive
- kualifikimin e vazhdueshëm shkencor të stafit pedagogjik dhe përmirësimin e teknikave të mësimdhënies
- përshtatjen e vazhdueshme të programeve të studimit të ofruara me nevojat e tregut të brendshëm dhe të huaj.

Programi mësimor në Departamentin e Matematikës ofron nivelet e studimit:

- Bachelor
- Masteri Shkencave
- Doktoraturë

Strategjia e kërkimit shkencor

Të realizojë kërkimin shkencor dhe të sigurojë raportin e përshtatshëm ndërmjet mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve që ofron. Institucionet e arsimit të lartë luajnë një rol shumë të madh për zhvillimin e shkencës, sepse janë ato që transmetojnë dijet shkencore tek brezat e rinj dhe që edukojnë studentët si shkencëtarë të ardhshëm me frymën dhe metodologjinë e kërkimit të mirëfilltë shkencor. Synimi i tij është që të përgatisë të rinj të arsimuar të cilët të jenë të aftë jo vetëm për tregun e punës por edhe më një portofol të mirëfilltë shkencorë:

1. Cilësinë, barazinë dhe standartete në arsim, tërheqjen në radhë të parë të elementëve të talentuar, gjenerimin e ideve të reja dhe menaxhimin e informacionit në fushën e kërkimit shkencor;
2. Krijimin e një klime që reflekton idetë e përbashkëta, vlerat, vizionin, besimin dhe që karakterizohet nga baraspesha midis mbështetjes dhe nxitjes;
3. Zbatimin e kodit etik si një dokument i bazuar në integritetin profesional e vetjak, në respektin e ndërsjellë, në përgjegjshmërinë dhe në arritjet akademike njëkohësisht;



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR

4. Cilësinë e institucionit, që mbështetet në organizimin ndërveprues menaxherial, në kërkimin shkencor të vazhdueshëm, në mësimdhënien e sukseshme dhe në pajisjet moderne bashkëkohore.

Objektivat:

Të përmbushë kushtet e përcaktuara nga strukturat e Edukimit në Vazhdim për formimin dhe kualifikimin e përhershëm të stafit akademik si pjesë e hapësirës evropine të arsimit të lartë.

- Të bëjë me dije kushtet e reja të zhvillimit profesional për studentët kandidatë për diplomim, duke i angazhuar ata në punë kërkimore shkencore dhe në konferenca e seminare me tematikë të përcaktuar.
- Studentët e pedagogët të jenë në vazhdimësi në kontakt me risitë dhe me literaturën bashkëkohore të shkruar ose elektronike.
- Të inkurajohet ndërtimi i urave lidhëse midis studentëve që zhvillojnë detyra kursi, punë kërkimore, stafit akademik dhe udhëheqësve të temave të diplomave.
- Nëpërmjet këshillimit të karrierës dhe në bashkëpunim me stafin akademik të ndihmohen maturantët të planifikojnë hapat për shkollimin e mëtejshëm bazuar në vendimmarrje të mirëmenduara për të ardhmen e tyre për të qenë pjesëtarë funksionalë të shoqërisë dhe për t'u punësuar sipas prirjeve të tregut të punës.
- Në programin e doktoraturës do të synohet të vazhdojnë studimet doktorale një pjesë e stafit të cilët janë në përfundim të mbrojtjes së saj dhe për vijueshmërinë e këtij cikli të nxisim sa më shumë stafin e ri.

Startegjia e kërkimit shkencor Departamenti i Shkencave Detare 2017-2022

Ky departament aspiron të jetë një mjedis ndërkombëtar i edukimit dhe trajnimit të detarëve dhe të jetë një ndër qendrat elitare rajonale mesdhetare të kërkimit shkencor dhe trajnimit në lëmin e detarisë.

Objektivat :

Departamenti i Shkencave Detare synon të jetë një nga Departamentet Elitare si dhe diplomat që lëshohen, të kenë vlerë reale dhe të jenë të kërkuara në tregun ndërkombëtar. Kjo nënkupton:

1. Konsolidimi i standarteve të edukimit,



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR

2. Konsolidimi i leadershipit në fushën e edukimit dhe trajnimit në rrafsh kombëtar dhe rajonal,
3. Konsolidimi i lidhjes me industrinë detare përmes shërbimit e research-it,
4. Orientimi i burimeve njerëzore dhe konsolidimi i lidhjes me tregun e punës,
5. Konsolidimi i Sistemit të Menaxhimit të cilësisë në fushën e edukimit dhe trajnimit të detarëve.

Plani strategjik për vitet 2017-2022:

1. Zgjerimi dhe modernizimi i infrastrukturës dhe aseteve teknologjike dhe llogjistikës,
2. Rritja e kapaciteteve akademike e profesionale të stafit si dhe kualifikimi i tij,
3. Zhvillimi i një kërkimi shkencor me rezultate të njohura kombëtarisht dhe ndërkombëtarisht. A) Njëpërmjet botimeve të rezultateve të kërkimit në buletine shkencore universitare dhe revista kombëtare dhe ndërkombëtare me faktor impakti. B) Pjesëmarrje në konferenca, simpoziume, workshop-e dhe seminare kombëtare dhe ndërkombëtare.
4. Pjesëmarrje në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare të lidhura me fushat e interesit të departamentit. A) Aplikim projektësh në nivel ndërkombëtar pranë Erasmus+, Horizon 2020. B) Zhvillim i projekteve konkurruese për të përfituar nga fondet e UV për kërkimin shkencor.
5. Zgjerimi dhe modernizimi i bazës materiale e didaktike;
6. Në kuadrin e edukimit në vazhdimësi, konsolidimi i Qendrës së Trajnimit të detarëve, në cilësinë e një qendre rajonale përse u përket trajnimeve siç edhe të zgjerojë gamën e veprimtarisë duke u shndërruar në një qendër kërkimore shkencore në fushën e detarisë.
7. Hapja e kurseve të reja të trajnimit në përputhje me nevojat e tregut të punës (kurset e avancuara për oficeret);
8. Përfshirja e subjekteve të tjera të industrisë detare si antare në të gjitha veprimtaritë e qendrës si rrjedhojë e kërkimit shkencor dhe risive në terma të zhvillimit teknologjik.
9. Rritja e kapaciteteve të researchit, teknologjisë dhe infrastrukturës (me klasa dhe terrene);
10. Krijimi i paketave të shërbimit për komunitetin e detarëve dhe industrinë detare;
11. Krijimi i network-ut mes Departamentit të Shkencave Detare dhe mjedisit të punësimit.
12. Organizimi në mënyrë periodike çdo 2 vjet i Konferencës Ndërkombëtare Detare.
13. Përfshirja e studentëve cilësorë në aktivitete dhe punë kërkimore shkencore, trajnime pranë UV dhe universiteteve me të cilat kemi bashkëpunim.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR

Fusha e veprimtarisë kërkimore-shkencore:

1. Hartimi, konsolidimi dhe përditësimi i Strategjisë së Kërkimit Shkencor, në bazë departamenti.
2. Vendosja në efikasitet të plotë e Qendrës së Trajnimit për Detarët dhe zgjerimin e paketës së Kurseve të Trajnimit.
3. Profilizimi dhe orientimi i kërkimit shkencor në fusha studimi nisur nga prioritetet e zhvillimit rajonal e kombëtar, për të maksimalizuar impaktin e tij.
4. Projekte kërkimore të përbashkëta me aktorë publikë e privatë rajonalë, kombëtarë e ndërkombëtarë.
5. Formalizimi dhe konsolidimi i lidhjes mes Departamentit të Shkencave Detare dhe Tregut të punës sipas sektorëve përkatës duke shfrytëzuar projektet kërkimore-shkencore.
6. Aplikimin e risive teknologjike, në funksion të tregut të tregut të punës së sektorit detar.
7. Kërkimi shkencor do të jetë në funksion të përditësimit, rifreskimit e zgjerimit të bazës teorike dhe praktike të kurrikulës së studimeve, dhe ofrimit të shërbimeve komunitare.
8. Rritja e rendimentit të aplikimeve për projekte të përbashkëta kombëtare dhe ndërkombëtare.
9. Krijimi i lidhjeve të qëndrueshme me partnerë ndërkombëtarë.

Strategjia e kërkimit shkencor Departamenti i Kimisë 2017-2022

Baza për përgatitjen e kësaj strategje mbështetet në :

1. Kapacitetet kërkimore zhvillimore të deritanishme të stafit
2. Strategjia aktuale kërkimore shkencore e UV
3. Modeli i ri strukturor i organikës së Departamentit të Kimisë
4. Pozicionimi gjeografik i institucionit
5. Rritja progresive e kualiteteve të studentëve
6. Përvoja pozitive e bashkëpunimeve partnerë të tjerë kërkimor-shkencor
7. Ofrimi së fundmi i investimeve në pajisje pranë Qendrës kërkimore shkencore të UV.

Vepimtaria :

1. Ngritja e pasurim i i një database të përgjithshme të të dhënave për gjirin e Vlorës.
2. Kualifikimi i vazhdueshëm i stafit akademik për grada e tituj.
3. Vlerësim periodik mjedisor mbështetur dhe nga temat e diplomës së Bch e MSc.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR

4. Botime e prezantime të punimeve shkencore të stafit në revista e konferenca shkencore të kërkuar.
5. Publikim i punëve kualitative të studentëve të Msc e Bch.
6. Rritja e bashkëpunimit me homologët vendas e ndvrkombvitar të fushës në kuadrv të unifikimit të programeve
7. Aplikime të departamentit të Kimisë në projekte të programeve kombëtare e ndërkombëtare.
8. Pasurimi i laboratorëve të Kimisë Analitike, Kimisë së Mjedisit, Kimisë Fizike.
9. Rritja e bashkëpunimit të stafit e studentëve me agjensi, organizata e qendra mjedisore vendase e të huaja.
10. Krijimi I aksesit të punimeve të pedagoqeve në faqen e departamentit të Kimisë në faqen zyrtare të UV

Ana pozitive :

1. Kërkime të vazhdueshme të stafit Bch e Msc. Shkëmbim eksperiencash dhe realizim i praktikave në terren për zhvillimin e kërkimit shkencor të stafit dhe studentëve të Masterit Shkencor.
2. Premisë për ngritjen profesionale dhe kualifikim. Shkëmbim eksperiencash dhe realizime të përbashkëta të punimeve shkencore si për stafin dhe studentët e Masterit Shkencor.
3. Krijimi i rrjeteve profesionale akademike të vazhdueshme.
4. Prania e punimeve cilësore
5. Mobiliteti I stafit si dhe përvoja e deritanishme e stafit.
6. Bashkëpunimi me revistat shkencore ku botohet; ndihma nga politikat e UV

Rezultatet e pritshme:

1. Vlerësim sistematik i Gjirit të Vlorës.
2. Shtrirja më tej e punës kërkimore shkencore si dhe përfshirja e stafit të ri në kualifikim
3. Ngritja e zbatimi i protokolleve vlerësues mjedisor
4. Arritje profesionale nvpërmjet punimeve dinjitoze
5. Ngritja e një eksperience pozitive të tillë.
6. Organizime të përbashkëta kërkimore e shkencore dhe akademike]sigurimi i rojekteve me natyrë mjedisore/edukative
7. Sigurimi i një biblioteke me hard- copy e soft- copy.
8. Zhvillimi i të gjitha oerëve të laboratorit me materialet e koleksionuara.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR

9. Shtrirja e bashkëpunimit reciprok.
10. Prezantimi i punimeve.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Specialiste:
Gentjana Belulaj
Jonida Mici

Ky dokument përpilohet në 3 (tre) kopje.



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORE
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SEKTORI I KËRKIMIT SHKENCOR